



**UNIVERSITETI “FAN S. NOLI” KORÇË  
FAKULTETI I BUJQËSISË**

# **DISERTACION**

**PARASHIKIMI I DIAMETRIT E PESHËS SË  
KOKRRAVE SI DHE PËRCAKTIMI I PERIUDHËS TË  
VJELJES TË TRE KULTIVARËVE TË MOLLËS**

Disertacion në kërkim të gradës “Doktor i Shkencave”  
në Hortikulture të Qëndrueshme

**DISERTANT**  
**MSc. Dhimitri PAPAMIHAL**

**UDHËHEQËS SHKENCOR**  
**Prof. Dr. Kristaq TENEQEXHI**

**Korçë, 2014**

**UNIVERSITETI “FAN S. NOLI” KORÇË**  
**FAKULTETI I BUJQËSISË**

**PARASHIKIMI I DIAMETRIT E PESHËS SË**  
**KOKRRAVE SI DHE PËRCAKTIMI I PERIUdhËS SË**  
**VJELJES SË TRE KULTIVARËVE TË MOLLËS**

Disertacion në kërkim të gradës “Doktor i Shkencave”  
në Hortikulturë të Qëndrueshme

**DISERTANT**  
**MSc. Dhimitri PAPAMIHAL**

**UDHËHEQËS SHKENCOR**  
**Prof. Dr. Kristaq TENEQEXHI**

U mbrojt në datën 9 korrik 2014 para komisionit të përbërë nga:

1. Prof. As. Dr. Irena KALLÇO      Kryetare      (.....)
2. Prof. As. Dr. Gjergji MERO      Oponent      (.....)
3. Prof. Dr. Lush SUSAJ      Oponent      (.....)
4. Prof. Dr. Petrit RAMA      Anëtar      (.....)
5. Prof. As. Dr. Edmond SPAHIU      Anëtar      (.....)

COPYRIGHT

I

DHIMITRI PAPAMIHAL

VITI 2014

**Udhëheqësi i studentit Dhimitri PAPAMIHAL vërteton se ky është  
versioni i miratuar i disertacionit të mëposhtëm:**

**“PARASHIKIMI I DIAMETRIT E PESHËS SË  
KOKRRAVE SI DHE PËRCAKTIMI I PERIUDHËS SË  
VJELJES SË TRE KULTIVARËVE TË MOLLËS”**

**Udhëheqësi shkencor  
Prof. Dr. Kristaq TENEQEXHI**

**PARASHIKIMI I DIAMETRIT E PESHËS SË  
KOKRRAVE SI DHE PËRCAKTIMI I PERIUDHËS SË  
VJELJES SË TRE KULTIVARËVE TË MOLLËS**

**Përgatitur nga grada e mëparshme MSc. Dhimitri PAPAMIHAL**

**Disertacion i paraqitur në:**

**Fakulteti i Bujqësisë**

**Universiteti Fan S. Noli Korce**

**Në përputhje të plotë**

**Me kërkesat**

**Për gradën Doktor**

**Universiteti Fan S. Noli Korce**

**Korrik 2014**

## **FALENDERIM**

Falenderoj në mënyrë të veçantë Prof.dr. Kristaq TENEQEXHI i cili si udhëheqësi im në këtë disertacion më ka qëndruar vazhdimisht pranë duke më siguruar të gjithë mbështetjen dhe inkurajimin e nevojshëm.

Një falenderim i posaçëm shkon për fermerin e palodhur Ferdinand ALIU, i cili më mundësoi të kryeja studimin në pemëtoren e tij për dy vite, duke më ofruar gjithashtu të dhëna të detajuara për shërbimet agroteknike të kryera gjatë kësaj periudhe.

Falenderoj pedagogët e Fakultetit të Bujqësisë të Universitetit “Fan S. Noli” Korçe për gjitha vërejtjet, sugjerimet dhe përkrahjen që më kanë dhënë gjatë referimeve të temës së doktoraturës.

Së fundmi, më shume se nje falënderim i rezervoj djalit tim Gjergji, që u tregua i palodhur e më dha ndihmë të paçmuar për realizimin e matjeve të shumta të kokrave, hedhjen e tyre në database si dhe përpunimin kompjuterik.

Dhimitri PAPAMIHAL

## **Deklaratë mbi origjinalitetin**

Une i nenshkruari Dhimitri PAPAMIHAL deklaroj se:

- Kjo tezë përfaqëson punën time origjinale dhe nuk kam përdorur burime të tjera, përveç atyre të evidentuara nëpërmjet citimeve.
- Të gjitha të dhënat, tabelat, figurat, grafiket dhe citimet në tekst të cilat janë riprodhuar prej ndonjë burimi tjetër, duke përfshirë dhe internetin, janë pranuar në mënyrë eksplicite si të tilla.
- Jam i vetëdijshëm se në rastin kur veprimet e mia bien në kundërshtim me Rregulloren për studimin e doktoraturës në kërkim të gradës “Doktor në hortikulture të qëndrueshme” të Universitetit “Fan S. Noli”, Fakulteti i Bujqësisë, ndaj meje mund të merren masat e parashikuara në nenin 29 të kësaj rregulloreje.

Korçë, më 09.07.2014

Firma

# PËRMBAJTJA E LËNDËS

|   |           |
|---|-----------|
| <b>1. HYRJE .....</b>   | <b>6</b>  |
| <b>1.1. PËRGJITHËSIME.....</b>  | <b>6</b>  |
| <b>1.2. MOLLA NË RAJONIN E KORÇËS.....</b>  | <b>7</b>  |
| <b>1.3. RËNDËSIA E STUDIMIT.....</b>  | <b>10</b> |
| <b>1.4. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E STUDIMIT .....</b>   | <b>13</b> |
| <b>1.5. SI TRAJTOHEN SOT KËTO ÇËSHTJE NË BOTË .....</b>   | <b>13</b> |
| <b>1.5.1. RRRITJA E DIAMETRIT DHE PESHËS SË FRUTIT TË MOLLËS .....</b>  | <b>13</b> |
| <b>1.5.2. PËRCAKTIMI I PJEKJES SË FRUTIT TË MOLLES.....</b>   | <b>16</b> |
| <b>2. MATERIALI DHE METODA .....</b>  | <b>19</b> |
| <b>2.1. TË DHENA PËR VENDOSJEN E STUDIMIT.....</b>  | <b>19</b> |
| <b>2.2. PËRCAKTIMI I EKUACIONIT ME TË PËRSHTATSHËM TË REGRESIONIT PËR RRRITJEN E DIAMETRAVE EKUATORIALE DHE GJATËSORË TË FRUTAVE NË FUNKSION TË SHUMES TË TEMPERATURAVE DITORE TË RRRITJES.....</b>               | <b>23</b> |
| <b>2.3. PËRPILIMI I TABELAVE PARASHIKUESE TË RRRITJES SË DIAMETRAVE NË FUNKSION TË SHUMES SË TEMPERATURAVE DITORE TË RRRITJES.....</b>  | <b>24</b> |
| <b>2.4. PËRLLOGARITJA E EKUACIONEVE TË REGRESIONIT QË SHPREHIN MARRËDHËNIEN NDËRMJET PESHËS SË FRUTAVE NË FUNKSION TË DIAMETRAVE EKUATORIALE DHE GJATËSORE TË TYRE.....</b>                                       | <b>25</b> |
| <b>2.5. PËRCAKTIMI I PERIUdhËS SË VJELJES BAZUAR NË TREGUESIT E PJEKJES SË FRUTAVE.....</b>   | <b>26</b> |
| <b>3. REZULTATET DHE DISKUTIMI .....</b>  | <b>29</b> |
| <b>3.1. KULTIVARI GOLDEN DELICIOUS .....</b>  | <b>30</b> |
| <b>3.1.1. PËRCAKTIMI I EKUACIONIT ME TË PËRSHTATSHËM TË REGRESIONIT QË SHPREH MARRËDHËNIEN NDËRMJET RRRITJES SË DIAMETRIT DHE SHUMES TË TEMPERATURAVE DITORE TË RRRITJES TË KULTIVARIT GOLDEN DELICIOUS.....</b>  | <b>33</b> |
| <b>3.1.2. PËRPILIMI I TABELËS PARASHIKUESE PËR RRRITJEN E DIAMETRIT EKUATORIAL DHE GJATËSOR TË KULTIVARIT GOLDEN DELICIOUS NË LIDHJE ME SHUMAT FIKSE TË TEMPERATURAVE DITORE TË RRRITJES NË TË DY VITET .....</b> | <b>35</b> |
| <b>3.1.3. PËRLLOGARITJA E EKUACIONEVE TË REGRESIONIT QË SHPREHIN MARRËDHËNIEN NDËRMJET PESHËS SË FRUTAVE TË GOLDEN DELICIOUS NË FUNKSION TË DIAMETRAVE EKUATORIALE DHE GJATËSORE TË TYRE. ....</b>                | <b>38</b> |
| <b>3.1.4. PËRCAKTIMI I PERIUdhËS SË VJELJES BAZUAR NË TREGUESIT E PJEKJES SË FRUTAVE.....</b>   | <b>40</b> |



|  |    |
|--|----|
| 3.1.5. NDJEKJE E ECURISË SË PJEKJES SË FRUTAVE TË KULTIVARIT<br>GOLDEN DELICIOUS DUKE PËRDORUR INDEKSIN STREIF .....   | 45 |
| 3.2. KULTIVARI RED CHIEF .....   | 47 |
| 3.2.1. PËRCAKTIMI I EKUACIONIT ME TË PËRSHTATSHËM TË<br>REGRESIONIT QË SHPREH MARRËDHËNIEN NDËRMJET RRRITJES SË<br>DIAMETRIT DHE SHUMES TË TEMPERATURAVE DITORE TË RRRITJES TË<br>KULTIVARIT RED CHIEF.....    | 51 |
| 3.2.2. PËRPILIMI I TABELËS PARASHIKUESE PËR RRRITJEN E DIAMETRIT<br>EKUATORIAL DHE GJATËSOR TË KULTIVARIT RED CHIEF NË LIDHJE<br>ME SHUMAT FIKSE TË TEMPERATURAVE DITORE TË RRRITJES NË TË DY<br>VITET.....    | 53 |
| 3.2.3. PËRLLOGARITJA E EKUACIONEVE TË REGRESIONIT QË<br>SHPREHIN MARRËDHËNIEN NDËRMJET PESHËS SË FRUTAVE TË RED<br>CHIEF NË FUNKSION TË DIAMETRAVE EKUATORIALE DHE GJATËSORE<br>TË TYRE.....                   | 56 |
| 3.2.4. PËRCAKTIMI I PERIUdhËS SË VJELJES BAZUAR NË TREGUESIT E<br>PJEKJES SË FRUTAVE.....  | 58 |
| 3.2.5. NDJEKJE E ECURISË SË PJEKJES SË FRUTAVE TË KULTIVARIT RED<br>CHIEF DUKE PËRDORUR INDEKSIN STREIF .....  | 63 |
| 3.3. KULTIVARI GRANNY SMITH .....  | 65 |
| 3.3.1. PËRCAKTIMI I EKUACIONIT ME TË PËRSHTATSHËM TË<br>REGRESIONIT QË SHPREH MARRËDHËNIEN NDËRMJET RRRITJES SË<br>DIAMETRIT DHE SHUMES TË TEMPERATURAVE DITORE TË RRRITJES TË<br>KULTIVARIT GRANNY SMITH..... | 68 |
| 3.3.2. PËRPILIMI I TABELËS PARASHIKUESE PËR RRRITJEN E DIAMETRIT<br>EKUATORIAL DHE GJATËSOR TË KULTIVARIT GRANNY SMITH NË<br>LIDHJE ME SHUMAT FIKSE TË TEMPERATURAVE DITORE RRRITJES NË<br>TË DY VITET.....    | 71 |
| 3.3.3. PËRLLOGARITJA E EKUACIONEVE TË REGRESIONIT QË<br>SHPREHIN MARRËDHËNIEN NDËRMJET PESHËS SË FRUTAVE TË<br>GRANNY SMITH NË FUNKSION TË DIAMETRAVE EKUATORIALE DHE<br>GJATËSORE TË TYRE.....                | 74 |
| 3.3.4. PËRCAKTIMI I PERIUdhËS SË VJELJES BAZUAR NË TREGUESIT E<br>PJEKJES SË FRUTAVE.....  | 75 |
| 3.3.5. NDJEKJE E ECURISË SË PJEKJES SË FRUTAVE TË KULTIVARIT<br>GRANNY SMITH CHIEF DUKE PËRDORUR INDEKSIN STREIF .....   | 80 |
| 4. PERFUNDIME.....   | 84 |
| 4.1. EKUACIONI I REGRESIONIT PËR RRRITJEN E DIAMETRIT NË FUNKSION<br>TË SHUMES TË TEMPERATURAVE DITORE TË RRRITJES.....  | 84 |
| 4.2. TABELAT E RRRITJES TË DIAMETRAVE NË FUNKSION TË SHUMES<br>FIKSE SË TEMPERATURAVE DITORE TË RRRITJES.....  | 84 |

|   |            |
|---|------------|
| <b>4.3. MARRËDHËNIA NDËRMJET PESHËS SË KOKRRAVE E DIAMETRAVE EKUATORIALE DHE GJATËSORE TË TYRE.....</b>   | <b>85</b>  |
| <b>4.4. PËRCAKTIMI I PERIUdhËS SË VJELJES BAZUAR NË TREGUESIT E PJEKJES SË FRUTAVE.....</b>   | <b>86</b>  |
| <b>5. SUMMARY: “PREDICTION OF DIAMETERS AND MASS AND DETERMINATION OF HARVEST TIME OF THREE APPLE CULTIVARS GOLDEN DELICIOUS RED CHIEF AND GRANNY SMITH”.....</b> | <b>87</b>  |
| <b>6. LITERATURA: .....</b>   | <b>106</b> |

### **Lista e Tabelave**

|   |    |
|---|----|
| Tabela 1.1. Vlerat ushqimore për 100 gram mollë të freskët (sipas USDA) .....                 | 6  |
| Tabela 1.2. Numri i rrënjëve dhe prodhimi i mollës për vitin 2013 .....                       | 9  |
| Tabela 3.1. Frutat e Golden Delicious sipas diametrave ekuatoriale në 40 DPLP .....           | 30 |
| Tabela 3.2. Frutat e Golden Delicious sipas diametrave gjatësorë në 40 DPLP.....              | 30 |
| Tabela 3.3. DPLP në datat korresponduese të tyre dhe $\Sigma T$ për Golden Delicious.....     | 31 |
| Tabela 3.4. Diametrat ekuatoriale e gjatësorë të Golden Delicious 40 – 152 DPLP...32          |    |
| Tabela 3.5. Krahasimi i tre modeleve të ekuacioneve për diametrat ekuatoriale .....           | 34 |
| Tabela 3.6. Krahasimi i tre modeleve të ekuacioneve për diametrat gjatësorë.....              | 35 |
| Tabela 3.7. Rritja e grup diametrave sipas shumave fikse të temperaturave të rritjes.36       |    |
| Tabela 3.8. Peshë e frutit e Golden Delicious për secilin grup diametrash në 152 DPLP.....    | 39 |
| Tabela 3.9. Parashikimi i peshës së frutave të Golden Delicious në 131, 138 dhe 145 DPLP..... | 39 |
| Tabela 3.10. Fortësia e frutave të Golden Delicious (viti 2012).....                          | 41 |
| Tabela 3.11 Fortësia e frutave e Golden Delicious (viti 2013) .....                           | 41 |
| Tabela 3.12. Totali i lendeve të tretshme i Golden Delicious (viti 2012) .....                | 42 |
| Tabela 3.13 Totali i lendeve të tretshme i Golden Delicious (viti 2013) .....                 | 43 |
| Tabela 3.14. Treguesi i amidonit i Golden Delicious (viti 2012).....                          | 44 |
| Tabela 3.15. Treguesi i amidonit i Golden Delicious (viti 2013).....                          | 45 |
| Tabela 3.16. Treguesit e pjekjes dhe Indeksi Streif i Golden Delicious (viti 2012) ....       | 46 |
| Tabela 3.17. Treguesit e pjekjes dhe Indeksi Streif i Golden Delicious (viti 2013) ....       | 47 |
| Tabela 3.18. Frutat e Red Chief sipas diametrave ekuatoriale në 40 DPLP .....                 | 48 |
| Tabela 3.19. Frutat e Red Chief sipas diametrave gjatësorë në 40 DPLP.....                    | 48 |
| Tabela 3.20. DPLP në datat korresponduese të tyre dhe $\Sigma T$ për Red Chief.....           | 49 |
| Tabela 3.21. Diametrat ekuatoriale e gjatësorë të Red Chief 40 – 152 DPLP .....               | 50 |
| Tabela 3.22. Krahasimi i tre modeleve të ekuacioneve për diametrat ekuatoriale.....           | 52 |

|   |    |
|---|----|
| Tabela 3.23. Krahasimi i tre modeleve të ekuacioneve për diametrat gjatësorë.....           | 53 |
| Tabela 3.24. Rritja e diametrave të Red Chief dhe temperaturat e rritjes .....              | 54 |
| Tabela 3.25. Pesha e frutit e Red Chief për secilin grup diametrash në 152 DPLP ....        | 57 |
| Tabela 3.26. Parashikimi i peshës së frutave të Red Chief në 131, 138 dhe 145 DPLP .....    | 58 |
| Tabela 3.27. Fortësia e frutave e Red Chief (viti 2012).....                                | 59 |
| Tabela 3.28. Fortësia e frutave e Red Chief (viti 2013).....                                | 59 |
| Tabela 3.29. Totali i lendeve të tretshme i Red Chief (viti 2012) .....                     | 60 |
| Tabela 3.30. Totali i lendeve të tretshme i Red Chief (viti 2013) .....                     | 61 |
| Tabela 3.31. Treguesi i amidonit i Red Chief (viti 2012) .....                              | 62 |
| Tabela 3.32. Treguesi i amidonit i Red Chief (viti 2013) .....                              | 62 |
| Tabela 3.33. Treguesit e pjekjes dhe Indeksi Streif i Red Chief (viti 2012).....            | 63 |
| Tabela 3.34. Treguesit e pjekjes dhe Indeksi Streif i Red Chief (viti 2013).....            | 64 |
| Tabela 3.35. Frutat e Granny Smith sipas diametrave ekuatoriale në 40 DPLP .....            | 65 |
| Tabela 3.36. Frutat e Granny Smith sipas diametrave gjatësorë në 40 DPLP .....              | 65 |
| Tabela 3.37. DPLP në datat korresponduese të tyre dhe $\Sigma T$ për Granny Smith .....     | 66 |
| Tabela 3.38. Diametrat ekuatoriale e gjatësorë të Granny Smith nga 40 – 159 DPLP ....       | 68 |
| Tabela 3.39. Krahasimi i tre modeleve të ekuacioneve për diametrat ekuatoriale.....         | 70 |
| Tabela 3.40. Krahasimi i tre modeleve të ekuacioneve për diametrat gjatësorë.....           | 70 |
| Tabela 3.41. Rritja e diametrave të Granny Smith dhe temperaturat e rritjes.....            | 72 |
| Tabela 3.42. Pesha e frutit e Granny Smith për secilin grup diametrash në 159 DPLP .....    | 74 |
| Tabela 3.43. Parashikimi i peshës së frutave të Granny Smith në 138, 145 dhe 152 DPLP ..... | 75 |
| Tabela 3.44. Fortësia e frutave e Granny Smith (viti 2012).....                             | 76 |
| Tabela 3.45. Fortësia e frutave e Granny Smith (viti 2013).....                             | 77 |
| Tabela 3.46. Totali i lendeve të tretshme i Granny Smith (viti 2012).....                   | 78 |
| Tabela 3.47. Totali i lendeve të tretshme i Granny Smith (viti 2013).....                   | 79 |
| Tabela 3.48. Treguesi i amidonit i Granny Smith (viti 2012) .....                           | 79 |
| Tabela 3.49. Treguesi i amidonit i Granny Smith (viti 2013) .....                           | 80 |
| Tabela 3.50. Treguesit e pjekjes dhe Indeksi Streif i Granny Smith (viti 2012).....         | 81 |
| Tabela 3.51. Treguesit e pjekjes dhe Indeksi Streif i Granny Smith (viti 2013).....         | 82 |

## **Lista e fotove**

|  |    |
|--|----|
| Foto 1.1. Fruti i mollës në stadi të ndryshme zhvillimi..... | 14 |
|--|----|

|  |    |
|--|----|
| Foto 2.1. Matja e diametrit të frutave me kalibër elektronik .....                           | 21 |
| Foto 2.2. Regjistri elektronik për kultivarin Red Chief me diametrat e grupuar .....         | 22 |
| Foto 2.3. Krahasimi i tre modeleve të regresionit për rritjen e diametrave .....             | 24 |
| Foto 2.4. Diametri në vlera fikse të shumës të temperaturave të rritjes ( $\Sigma T$ ) ..... | 25 |
| Foto 2.5. Peshimi i frutave të porsavjele.....   | 26 |
| Foto 3.1. Përzgjedhja e modelit të ekuacionit të Golden Delicious për De 26.76 mm .....      | 33 |
| Foto 3.2. Shndrimi i amidonit në sheqerna në 145 DPLP (viti 2012).....                       | 44 |
| Foto 3.3. Përzgjedhja e modelit të ekuacionit të Red Chief për De 32.06 mm.....              | 52 |
| Foto 3.4. Përzgjedhja e modelit të ekuacionit të Granny Smith për De 28.37 mm .....          | 69 |
| Foto 3.5. Matja e fortësisë së kultivarit Granny Smith 159 DPLP (viti 2013) .....            | 76 |

### **Lista e figurave**

|   |    |
|---|----|
| Figura 2.1. Planimetria e pemtores ku u krye studimi .....                | 20 |
| Figura 2.2. Njolllosja rrezore për Golden Delicious dhe Granny Smith..... | 28 |
| Figura 2.3. Njolllosja rrethore për Red Chief .....                       | 29 |

### **Lista e grafikëve**

|  |    |
|--|----|
| Grafiku 1.1. Struktura e kultivarëve të mollës në rrethin e Korçës (viti 2012) .....                 | 10 |
| Grafiku 1.2. Ndryshimet fiziologjike të frutit të mollës nga lulëzimi në vjelje.....                 | 15 |
| Grafiku 3.1. Rritja e diferencës mes grup-diametrave ekuatoriale të kultivari Golden Delicious ..... | 38 |
| Grafiku 3.2. Indeksi Streif i kultivarit Golden Delicious në vitin 2012 dhe 2013.....                | 47 |
| Grafiku 3.3. Rritja e diferencës mes grup-diametrave ekuatorialë të kultivari Red Chief.....         | 56 |
| Grafiku 3.4. Indeksi Streif i kultivarit Red Chief në vitin 2012 dhe 2013 .....                      | 65 |
| Grafiku 3.5. Rritja e diferencës mes grup-diametrave ekuatorialë të kultivari Granny Smith .....     | 73 |
| Grafiku 3.6. Indeksi Streif i kultivarit Granny Smith në vitin 2012 dhe 2013 .....                   | 83 |

# 1. HYRJE

## 1.1. PËRGJITHËSIME

Molla (*Malus domestica* Borkh) bën pjese në familjen Rosaceae, në gjininë Malus. Ajo është ndër speciet me të lashta drufrutore, frutat e së cilës janë konsumuar nga njeriu që në vitet e para të civilizimit, kohe kur ka filluar dhe kultivimi i saj.

Të dhënat tregojnë se molla e kultivuar e ka origjinën nga Azia qendrore. Ka shumë mundësi që paraardhësi i saj kryesor të ketë qene *Malus sieversii*, nga Vargmalet Qiellore (Tien Shan) në kufi mes Kinës Perëndimore, ish Bashkimit Sovjetik dhe Azisë qendrore (Janick et al., 1996). Mollët janë kultivuar për mijëra vite në Azi dhe Evropë, e me vone në Amerike, në kohën e kolonizimit të saj nga Evropianet.

Frutat e mollës dallohen për shijen, aromën, lëngun, freskinë dhe vlerën e tyre ushqimore dhe dietetike, të cilat i dedikohen përmbajtjes së sasive të konsiderueshme të vitaminave, acideve organike, elementeve dhe mikroelemente shumë të dobishëm për trupin e njeriut (Tabela 1.1).

**Tabela 1.1. Vlerat ushqimore për 100 gram mollë të freskët (sipas USDA)**

| Nr        | Emërtimi         | Njësia   | %    | Nr         | Emërtimi                 | Njësia   | %  |
|-----------|------------------|----------|------|------------|--------------------------|----------|----|
| <b>I</b>  | <b>Energji</b>   | 52 kcal  | 2.5% | <b>III</b> | <b>Elektrolite</b>       |          |    |
| 1         | Karbohidrate     | 13.81 g  | 11 % | 1          | Natrium                  | 1mg      | 0% |
| 2         | Proteina         | 0.26 g   | 0.5% | 2          | Kalium                   | 107 mg   | 2% |
| 3         | Yndyra           | 0.17 g   | 0.5% | <b>IV</b>  | <b>Metale</b>            |          |    |
| 4         | Kolesterol       | 0 mg     | 0%   | 1          | Kalcium                  | 6 mg     | 1% |
| 5         | Fibra dietike    | 2.40 g   | 6%   | 2          | Hekur                    | 0.12 mg  | 1% |
| <b>II</b> | <b>Vitamina</b>  |          |      | 3          | Magnez                   | 5 mg     | 1% |
| 1         | Folate           | 3 µg     | 1%   | 4          | Fosfor                   | 11 mg    | 2% |
| 2         | Niacin           | 0.091 mg | 1%   | 5          | Zink                     | 0.04 mg  | 0% |
| 3         | Acid pantothenik | 0.061 mg | 1%   | 6          | Mangan                   | 0.035 mg | 2% |
| 4         | Vitamin B6       | 0.041 mg | 3%   | <b>V</b>   | <b>Fito-nutrientë</b>    |          |    |
| 5         | Riboflavine      | 0.026 mg | 2%   | 1          | Karrotin-B               | 27 µg    | -  |
| 6         | Tiamin           | 0.017 mg | 1%   | 2          | Crypto-xanthin-B         | 11 µg    | -  |
| 7         | Vitaminë A       | 54 IU    | 2%   | 3          | Lutein-zeaxanthin        | 29 µg    | -  |
| 8         | Vitaminë C       | 4.6 mg   | 6%   | <b>VI</b>  | <b>Perberes të tjere</b> |          |    |
| 9         | Vitaminë E       | 0.18 mg  | 1%   | 1          | Uje                      | 85.56 g  | -  |
| 10        | Vitaminë K       | 2.2 µg   | 2%   | 2          | Florde                   | 3.3 µg   | -  |

Proverbi i anglez i shekullit XIX se “nje molle në dite e mban doktorin larg” u adresohet efekteve pozitive të mollës në shëndetin e njeriut. Studimet shkencore kanë treguar se mollët ndikojnë në reduktimin e rrezikut nga disa lloje kanceri,

si ai i zorrës se trashe, i prostatës dhe i mushkërive. Lëvoret e mollëve përmbajnë acid ursolik i cili rrit muskujt e skeletit dhe dhjamin ngjyre kafe, duke ulur njëkohësisht dhjamin e bardhe, obezitetin, intolerancën ndaj glukozës dhe rrezikun nga sëmundja e dhjamosjes së mëlçisë (SCC, 2008).

Mollët janë burim i nje sere kimikatesh bimore (fitokimikate) të dobishme për shëndetin e njeriut dhe me vlera ushqimore, të tilla si quercetin, epicatekin dhe procianidin B2 (Lee, 2004).

Molla është ndër speciet unike, frutat tulore të së cilës, në kushte të caktuara, mund të ruhen të freskëta dhe konsumohen pothuajse edhe një vit pas vjeljes, pa humbur parametrat e cilësisë së tyre. Kjo veçori gjenetike rrit disponueshmërisë gjithëvjetoje të këtij fruti për konsumatorët dhe minimizon efektet negative në periudhat pike të prodhimit që do të çonin në një zhbalancim të kërkese ofertës në treg.

Prodhimi i mollës në nivel botëror ka ardhur në rritje nga viti në vit. Sipas Organizatës Botërore të Bujqësisë dhe Ushqimit, gjatë periudhës dhjetë vjeçare 2003 – 2012 ai është shtuar me rreth 1.8 milion ton/vit, duke arritur shifrën e rreth 76.400.000 ton në vitin 2012 (FAO, 2012). Në prodhimin botëror të frutave molla rreshtohet e treta, pas agrumeve dhe bananes.

Përlllogaritjet tregojnë se deri tani në bote janë krijuar mbi 10 mijë kultivarë molle, ndërkohe që në institucionet kërkimore puna vazhdon për krijimin e kultivarëve të rinj me parametra cilësore me të larte, qëndrueshmëri me të madhe ndaj sëmundjeve dëmtuesve, etj. Megjithatë, në prodhimin e gjere sot në bote mbizotërojnë vetëm disa dhjetëra kultivarë (Janick et al., 1996).

## **1.2. MOLLA NË RAJONIN E KORÇËS**

Historikisht, molla është një ndër speciet drufrutore me të kultivuara në rajonin e Korçës. Për mollën e Korçës, hulumtimet e bëra tregojnë se është pikërisht malësia e Gorës ku mendohet se ajo është kultivuar që në lashtësi. Në Gore, por madje edhe në Opar, konstatohet dhe një lloj molle e egër me origjinë nga fara, e quajtur Mollçinka në gjuhën e popullit. Kjo molle, prej fillimeve të shekullit të 20-të e deri në ditët tona, ka shërbyer edhe si nënshartësë.

Në mes të shekullit të kaluar, në malësinë e Gorës gjendeshin akoma disa lloje të vjetra mollësh, të quajtura “Majoshka”, “Kulaçe” “Ohrinka” (kjo me origjinë të vjetër nga Ohri, Maqedoni) dhe “Ajvaneja”. Këto konsideroheshin si shumë të vjetra. Ndërkaq, lloji Ajvaneja gjendej në ato kohë edhe në Teqenë e Leskovikut, ndërsa në Pogradec ishte një lloj i vjetër molle i quajtur “E Shtrembra” që prodhonte fruta jo simetrike, por shumë të shijshëm. Në Bilisht gjendej molla e quajtur “E Shënd’Ilisë”(Hocishtarja), e evidentuar që në vitin 1936 tek manastiri i fshatit Hoçisht, e cila kish si karakteristikë hyrjen shume të vonshme në prodhim, pas 13 – 14 vitesh.

Përmendet se në vitet 1934 – 1938 në Korçë, Bilisht dhe në Pogradec, ka patur pemëtore të rregullta mollësh (Ballauri, 2011). Ndërkaq në vitin 1929, sipas literaturës, janë furnizuar pemëtoret e Shqipërisë me material nga Padova e Italisë, me kultivarët Anurka, Renet Kanadeze dhe Roza Montavana. Më 1933 janë importuar nga Firencia e Italisë kultivaret Starking, Delicious, Golden Delicious, Kalvila, Jonathan dhe Renete. Ndërkaq prej Ohrit dhe Resnjës, kanë hyrë sidomos në zonën e Korçës kultivaret Tetovka (pra nga Tetova) Karapashka (që emri i saktë i së cilës është Kara Pasha = pasha i zi), Jonathan, Ohrinka dhe Renete Kanada.

Gjate viteve të komunizmit puna u organizua në krijimin e blloqeve frutore në territorin e ndërmarrjeve shtetërore dhe kooperativave bujqesore të kohës. Mes tyre, plantacioni me drufrutore i Dvoranit në Korce, me mbi 700 ha pemëtore në terren fushor ishte me i rëndësishmi në Shqipëri për sa i përket kultivimit të mollës, dhe jepte çdo vit mbi 20% të prodhimit vendas të kësaj specie.

Në vitet e para të tranzicionit (1991 – 1993), si në të gjithë vendin edhe në rajonin e Korçës, sipërfaqja me drufrutore (përfshirë dhe mollën) dhe prodhimi u ulen ndjeshëm. Rimëkëmbja e frutikulturës ishte nje proces i ngadalshëm dhe për nje periudhe prej gati nje dekade e gjysmë, Shqipëria u kthye në nje vend importues të mollëve. Prodhimi vendas plotësonte kërkesat e konsumatorëve për nje periudhe dy mujore në vit. Ndonëse pemëtoret gjysmë intensive të mollëve me nënshartesa vegetative filluan të kultivoheshin që në vitet e fundit të komunizmit në rajonin e Korçës (pemëtorja Dvoran), dhe me pas në kopshtet private të fermerëve të rajonit, deri në fillim vitet 2000 ato kishin nje peshe modeste në ekonominë rajonale e të ardhurat e fermerëve.

Megjithatë, çmimet relativisht të larta të mollës në treg dhe gjenerimi prej saj i të ardhurave me të madhe për njësi sipërfaqe se sa nga bimët e arave ndikuan shume në ndërgjegjësimin e fermerëve dhe rritjen e sipërfaqes se kultivuar me molle në rajonin e Korçës pas vitit 2004. Nje kontribut të rëndësishëm në këtë drejtim kane dhënë dhe politikat shtetërore nëpërmjet zbatimit të skemave të ndryshme mbështetëse (subvencionuese) për drufrutoret dhe pemëtoret intensive me mollë në veçanti.

Si karakteristike e kësaj periudhe ishte krijimi i parcelave intensive me molle me madhësi nga 0.5 – 2 ha secila, përdorimi masiv i nënshartesave me rritje të dobët si EM9, dendësia e mbjelljes mbi 1500 rrënje/ha dhe ujitje me pika.

Kultivarët kryesore të mbjelle në pemëtoret e kësaj periudhe ishin Golden Delicious dhe Red Chief, frutat e të cilëve shiteshin në treg me çmime me të larte se ato të kultivarëve të tjerë, dhe pas tyre vinte kultivari Granny Smith, pa përjashtuar Fuji si dhe kultivarë të tjere me pjekje të hershme.

Nga statistikat e Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë në Korçë, për periudhën nga viti 2007 deri në fund të vitit 2013 në rajonin e Korçës u mbollën mesatarisht

çdo vit rreth 100 ha me molle. Në inventarin e fundit të vitit 2013 në këtë rajon figuronin 2468 ha me molle gjithsej, nga të cilat 2018 ha në prodhim, ndërsa prodhimi total i mollës për vitin 2013 ishte 44814 ton (Tabela 1.2), ose 3500 ton me shume se viti 2012.


**Tabela 1.2. Numri i rrënjëve dhe prodhimi i mollës për vitin 2013**

| Nr.        | Komuna / Rrethi / Rajoni | Molle gjithsej (Rrënjë) | Nga këto në prodhim (Rrënjë) | Prodhimi (ton) |
|------------|--------------------------|-------------------------|------------------------------|----------------|
| 1          | Komuna Lekas             | 5105                    | 5005                         | 295            |
| 2          | Komuna Vithkuq           | 10900                   | 10660                        | 426            |
| 3          | Komuna Mollaj            | 182730                  | 148470                       | 6666           |
| 4          | Komuna Drenove           | 98120                   | 80120                        | 3043           |
| 5          | Komuna Voskopoje         | 1600                    | 1600                         | 25             |
| 6          | Komuna Voskop            | 98900                   | 75180                        | 1888           |
| 7          | Komuna Vreshtas          | 22888                   | 18700                        | 383            |
| 8          | Komuna Pojan             | 257300                  | 184144                       | 5449           |
| 9          | Komuna Pustec            | 17060                   | 17060                        | 171            |
| 10         | Komuna Maliq             | 7308                    | 7308                         | 14             |
| 11         | Komuna Libonik           | 148105                  | 143705                       | 2946           |
| 12         | Komuna Pîrg              | 188100                  | 140400                       | 3182           |
| 13         | Komuna Gore              | 5235                    | 4555                         | 72             |
| 14         | Komuna Moglice           | 2510                    | 2225                         | 59             |
| 15         | Komuna Bulgarec          | 142808                  | 117271                       | 3169           |
| <b>I</b>   | <b>Rrethi Korçë</b>      | <b>1188669</b>          | <b>956403</b>                | <b>27788</b>   |
| <b>II</b>  | Rrethi Kolonje           | 129212                  | 121862                       | 3420           |
| <b>III</b> | Rrethi Devoll            | 687621                  | 608885                       | 11848          |
| <b>IV</b>  | Rrethi Pogradec          | 139539                  | 95536                        | 1759           |
|            | <b>Rajoni Korce</b>      | <b>2145041</b>          | <b>1782686</b>               | <b>44814</b>   |

Me hyrjen në prodhim të plote të parcelave të mbjella në këto vitet e fundit, trendi rritës i prodhimit të mollës në rajonin e Korçës do të vazhdoje, dhe sipas parashikimeve nga Drejtoria e Bujqësisë Korçë, pritet që në fund të vitit 2015 të arrije sasinë prej rreth 50.000 ton.

Gjate periudhës 2007 – 2012 në zonat tipike të kultivimit të mollës në rajonin e Korçës u ngritën 45 mjedise frigoriferike private, me kapacitet mestar prej 200 – 400 ton secili, të cilët magazinonjë molle për rreth 6 muaj.





**Grafiku 1.1. Struktura e kultivarëve të mollës në rrethin e Korçës (viti 2012)**

### 1.3. RËNDËSIA E STUDIMIT

Prodhimi dhe tregtimi i mollës në rajonin e Korçës ka rezultuar i suksesshëm deri në vitin 2012 për shkak të kërkesave në rritje të konsumatorëve për këtë fruit dhe shtimit të sipërfaqes së mbjelle e rritjes së kapacitetit magazinues frigoriferik. Megjithatë, rritja e vazhdueshme e prodhimit të mollës me një ritëm të tillë prej rreth 3.500 ton në vit është vështirë të ndiqet nga i njëjti trend në konsumin e saj të freskët nga shqiptaret apo thithjes të sasive të konsiderueshme nga industria përpunuese vendase, qofte dhe pas disa vitesh. Duke marrë parasysh parashikimet e prodhimit të mollës për vitin 2015, rezulton që vetëm rajoni i Korçës do të sigurojë rreth 20 kg molle në vit për çdo banor të Republikës së Shqipërisë nga rreth 14 kg në vitin 2011 (MBUMK, 2012). Kjo shifër përben një sasi të konsiderueshme, në një kohë që konsumi vendas i frutave në total nuk i kalon 60 kg/banor në vit (FAO, 2012) dhe industria përpunuese e mollës për marmelate e lëngje nuk po shënon rritje të kënaqshme.

Ndërkohë që rritja e prodhimit të mollës vazhdon, në shitjen e prodhimit për vitin 2013 u shfaqën problemet e para serioze për fermerët kultivues të mollës dhe bizneset frigoriferike të saj në rajonin e Korçës. Ata u përballen me vështirësi të mëdha të shkaktuara nga mos shitja e një sasive të konsiderueshme mollësh dhe reduktimi i çmimit nën atë të kontraktuar gjatë grumbullimit. Për rrjedhojë një pjesë e mirë e mollëve u kalben dhe groposen, një pjesë tjetër kaluan në cilësi me të ulët, duke minimizuar kështu të ardhurat e parashikuara nga munda e djersa

e nje viti pune. Mbi të gjitha filluan të shfaqen dilemat për realizimin e shitjeve në vitet në vazhdim, sepse prodhimi pritet të shënojë rritje të mëtejshme.

Tashme është evidente nevoja e rishqyrtimit të strategjisë kombëtare të shtimit të sipërfaqeve me molle në baze të aftësisë thithëse për këtë produkt nga tregu i brendshëm dhe të jashtëm. Prodhimi i frutave të mollës me cilësi të larte e me kosto të ulët mbeten faktorë kyç për këtë kulturë, të shoqëruara me një menaxhim bashkëkohor të sistemit të magazinimit e tregtimit.

Nisur nga këto, sfidat për të ardhmen e këtij sektori janë në shume plane e lidhen si me përsosjen e teknologjive të prodhimit e uljen e koston, rritjen e parametrave të cilësisë dhe sigurisë ushqimore, sikundër dhe me ruajtjen sa me afatgjate e me cilësi të larte të mollëve në magazinat frigoriferike.

Të gjitha këto marrin një rëndësi të veçantë në kushtet e një tregu të hapur e me konkurrence të lire mes Shqipërisë e vendeve të rajonit, përfshi dhe ato të BE. Nga ky këndvështrim plotësimi thuhet gjithë vjetor i nevojave të tregut të brendshëm dhe mundësimi i eksportit të mollës drejt vendeve të tjera do të jepte një frymëmarrje tjetër ekonomisë të fermerëve në rajonin e Korçës e me gjere, duke krijuar premisat baze për një zhvillim të qëndrueshëm të pemëtarisë. Ndërgjegjësimi për këtë çështje mes aktoreve të sektorit është i larte, por ndihma e eksperteve të fushës duhet të jete me madhe.

Mes një game të gjere përmirësimesh që duhen kryer, ka mes tyre nga dhe nga ato që nuk kërkojnë kosto shtese për fermerin ose mjediset frigoriferike. Ky studim do të përqendrohet në dy prej tyre që kane të bëjnë me:

- a) parashikimin e hershem të diametrave e peshës përfundimtare të frutave të mollës të tre kultivarëve kryesore të mollës në rajonin e Korçës Golden Delicious, Red Chief dhe Granny Smith, si dhe
- b) përcaktimin e periudhës me të përshtatshme për vjelje të këtyre kultivareve.

Tregjet e huaja prej shume vitesh, por edhe ai vendas në ditët tona, kërkojnë fruta - perime sipas standardeve ndërkombëtare. Në rastin e mollëve, si pjese e rëndësishme e parametrave të standardit të saj janë diametri e pesha e kokrrave së bashku me treguesit e cilësisë së tyre (fortësia, konsistenca, sheqernat, etj.), të cilët shërbejnë si variabla kryesore në tregtinë ndërkombëtare dhe në përcaktimin e çmimit të produktit për tregjet e synuara. Specifikimi i këtyre parametrave ka qene në objektin e punës dhe vëmendjen e organizmave ndërkombëtare të fushës. Komiteti i Organizatave Profesioniste të Bujqësisë (COPA) dhe Komiteti i Përgjithshëm për Kooperimin Bujqësor në Bashkimin Europian (COGECA) në studimin e tyre të vitit 2004 – 2005 dhe të paraqitur Komitetit Ekonomik për Evropën të Kombeve të Bashkuara (UNECE), theksuan ekzistencën e një marrëdhënie korrelacioni të drejtpërdrejtë midis peshës/madhësisë së frutave të mollës dhe nivelit të sheqernave të matura në <sup>0</sup>Brix (COPA – COGECA 2006).

Ata propozuan që pesha ose përmasat e frutave të përdoren si parametra kryesore të cilësisë në prodhimin botëror të këtij fruti, pa detyruar që në tregtinë ndërkombëtare të përdoren kërkesa dhe parametra të tjerë, të cilat nuk mund të maten me saktësi 100% me teknologjinë aktuale. Propozimet e tyre gjeten vend në rregulloren e BE të vitit 2008 (EC Regulation 1221/2008) për standardet e marketingut të frutave dhe perimeve, si dhe standardit 2010 të UNECE për mollën (UNECE - OECD 2010).

Sigurisht që përmasat dhe pesha përfundimtare e frutave të mollës janë rezultante të një numri faktorësh të rritjes: temperaturës, ndriçimit, lagështisë në toke dhe ajër, lendeve ushqimore të disponueshme, ngarkesës me kokrra për çdo peme, etj. si dhe veçorive biologjike të secilit kultivar. Harmonizimi sa me i mire i tyre do të siguronte marrjen e prodhimeve cilësore, me përmasa dhe peshe frutash brenda diapazonit me të kërkuar nga konsumatori vendas e standardet ndërkombëtare dhe kjo do të maksimizonte të ardhurat. Studimet në vendet e tjera kane treguar se në parcelat me molle ku zbatohen për vit një agroteknike e ngarkese me fruta të njëjtë, është i mundur të behet parashikimi i hershem i diametrit e peshës së frutave të mollës në vjelje në funksion të shumës të temperaturave ditore të rritjes. Rezultatet disa vjeçare do të ndihmonin kultivuesit në përshtatjet e nevojshme të ngarkesës me fruta për çdo rrënjë, në një planifikim me të mire e lidhjen në kohe të kontratave të shitjes, prokurimin e materialeve paketues, planifikimin paraprak të forcave të punës që nevojiten për procesin e vjeljes, etj. (Bramardi et al., 1997, Garritz et al., 1993, Ortega - Farias et al., 1998).

Nga ana tjetër, përcaktimi i periudhës me të përshtatshme të vjeljes se cdo kultivari sipas destinacionit të tij për konsum të menjëhershëm, magazinim afatshkurtër ose për frigoriferim afatgjatë, është një moment tjetër i rëndësishëm. Vjelja me herët ose me vonë se afati i duhur rezulton me pasoja veçanërisht për ato sasi mollësh të synuara për frigoriferim afatgjatë. Sipas studimeve të shume autoreve (Blanpied dhe Silsby 1992, Zerbini et al., 1999,) etj. pasojat shfaqen me humbje të cilësisë, peshës, aromës e konsistencës së frutave, me çrregullime të brendshme të tyre dhe firo me të mëdha nga kalbëzimet gjate dhe pas procesit të frigoriferimit.

Në vendin tone çështjet që kane të bëjnë me parashikimin e hershem të diametrit e peshës përfundimtare të frutave të mollës dhe përcaktimin e periudhës me të përshtatshme për vjelje, janë shume pak të njohura nga fermerët prodhues e bizneset magazinuese të mollës. Në një vrojtim të kryer në rrethin e Korçës në vitin 2011 me 12 biznesmenë të magazinave frigoriferike të mollës, rezultoi se për disa vite rresht që ata ushtronin këtë aktivitet, grumbullimin e mollëve Golden Delicious dhe Red Chief e bënin në të njëjtën periudhë, 24 Shtator - 5 Tetor, pa marrë parasysh kushtet specifike të çdo viti që mund të ndikonin në

grumbullim me të hershëm ose me të vonshëm. Si kriter për vlerësimin e pjekjes ata përdornin pamjen e jashtme të frutit, ngjyrimin kafe të farave, dhe vetëm dy prej tyre matnin totalin e lendeve të tretshme. Në të tilla kushte, ndërmarrja e nje studimi për çështjet e mësipërme do të ishte me vlerë.

#### **1.4. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E STUDIMIT**

Qëllimi kryesor i këtij studimi është:

**“Përcaktimi i modeleve matematikore që shprehin rritjen e diametrit dhe peshës së kokrrave të tre kultivarëve të mollës Golden Delicious, Red Chief dhe Granny Smith, të cilët mundësojnë parashikimin e hershem të këtyre parametrave si dhe përcaktimi i periudhës të vjeljes të këtyre kultivarëve bazuar në treguesit e pjekjes”.**

Nisur nga qëllimi kryesor i studimit, objektivat specifike për secilin kultivar janë:


- 1. Përcaktimi i ekuacionit me të përshtatshëm të regresionit për rritjen e diametrave ekuatoriale dhe gjatësorë të frutave në funksion të shumës të temperaturave ditore të rritjes.**
- 2. Përpilimi i tabelave parashikuese të rritjes së diametrave në funksion të shumës së temperaturave ditore të rritjes**
- 3. Përlllogaritja e ekuacioneve të regresionit që shprehin marrëdhënien ndërmjet peshës së frutave në funksion të diametrave ekuatoriale dhe gjatësore të tyre.**
- 4. Përcaktimi i periudhës së vjeljes bazuar në treguesit e pjekjes së frutave.**

#### **1.5. TË DHËNAT NGA LITERATURA**

##### **1.5.1. RITJA E DIAMETRIT DHE PESHËS SË FRUTIT TË MOLLËS**

Fruti i mollës e ka origjinën nga baza e lules pas pjalmimit dhe fekondimit të qelizave veze të saj. Pas rënies së petaleve, baza e vezores fillon të zmadhohet, duke dhënë frutin që marrin në vjelje, ashtu sic tregohet në Foton 1.1.

Prej dekadash me pare, studiuesit e hortikulturës janë përpjekur të gjejnë nje model matematikor të rritjes së përmasave e peshës së kokrrave të frutave të ndryshëm, përfshire dhe mollën. Përgjithësisht, në shumicën e teksteve dhe botimeve shkencore të hortikulturës, rritja e diametrit të kokrrave të mollës përshkruhet se i përngjan grafikisht formës të nje sinusoidë (Pratt, 1988; Faust, 1989), ndërsa shtimi në peshë nje vije pak a shume të përkulur, e cila në kushtet e prodhimit të gjere përgjithësisht pëson nje lakim me të madh në javët e fundit deri në pjekje (Grafiku 1.2.).




**Foto 1.1. Fruti i mollës në stade të ndryshme zhvillimi (vijeza e zeze = 1cm)**

Megjithatë, Blanpied (1966) dhe Assaf et al. (1982) kane arritur në përfundimin se në drurët e mollës me ngarkese minimale frutash, rritja e peshës së kokrrave në 3 – 5 javët e pas lulëzimit i ngjet nje kurbe të lakuar lehte, ndërsa në periudhën e mëvonshme deri në vjelje, ajo eshte lineare. Gourdiaan dhe Monteith (1990) përshkruan modelin e rritjes së kokrrave si nje ekuacion eksponencial-linear që shfaq nje rritje eksponenciale të lendes së thate në javët e para pas lulëzimit, e cila me vone ndiqet nga nje faze lineare rritje. Sipas tyre, rritja eksponenciale në fazat e para i dedikohet kapjes me të madhe të dritës nga gjethet e reja, ndërsa me mbylljen e kurorës kapja e dritës mbetet konstante dhe rritja eshte nje funksion linear i kësaj kapje. Pra, rritja e frutave të mollës behet në dy faza, nje faze e hershme e rritjes eksponenciale që karakterizohet nga ndarja qelizore, e cila zgjat zakonisht nga 3 – 5 jave pas lulëzimit dhe nje faze e dyte e zmadhimit të qelizave që vazhdon për pjesën e mbetur të rritjes deri në pjekje (Bollard, 1970; Blanpied dhe Wilde 1968; Pratt 1988).

Studiuesit e mësipërm propozuan që ekuacioni i rritjes eksponencial-linear të frutave të vlerësohet si nje derivat matematikor i modelit të rritjes potenciale të mollës, ku rritja potenciale përcaktohet si ajo që realizon fruti në kushte optimale të faktorëve të rritjes (ndriçim, lagështi, lende ushqimore, etj.) dhe pa konkurrencë nga frutat e tjerë. Në ndryshim nga kjo mënyre potenciale, rritja e frutave në pemëtoret e zakonshme eshte me e vogël, për shkak ngarkesës me të

madhe me fruta e konkurrencës mes tyre për lende ushqimore, por jo rrallë edhe për nivel të pamjaftueshëm të shërbimeve agroteknike.



**Grafiku 1.2. Ndryshimet fiziologjike të frutit të mollës nga lulëzimi në vjelje**

Lakso et al., (1995) provuan se rritja potenciale e kokrrave të mollëve ndikohet shumë nga temperaturat e ajrit, sikurse dhe nga niveli i rrezatimit diellor të kapur nga gjethet e pemëve. Rritja dhe zhvillimi i frutave kërkon një sasi të caktuar nxehtësie të grumbulluar në kohe, sepse temperatura është ajo që rregullon proceset fiziologjike të cilat marrin pjesë në rritjen dhe zhvillimin e bimës (Barcelo et al., 1990). Kjo sasi nxehtësie e grumbulluar në kohe, e cila është specifike për secilin stad të zhvillimit të bimëve përkufizohet si koha fiziologjike e nevojshme dhe nga ana sasiore matet nëpërmjet shumës së temperaturave ditore të rritjes ( $\Sigma T$ ) mbi pragun prej 10°C që konsiderohet si “zero vegjetative” (Zalom et al., 1983).

Në kompleksin e faktorëve klimatike që ndikojnë rritjen e zhvillimin e frutave të mollës, Kaack dhe Pedersen (2010) treguan se për kultivarin e mollës Elstar, mes 11 faktorëve të tilla të marre në studim, rolin kryesor në rritjen e diametrit

dhe peshës së frutave e kishte shuma e temperaturave ditore të rritjes. Lakso et al., (1995) dhe Lakso dhe Goffinet (2013) treguan se pavarësisht pozicionit të frutave në peme, ritmi i rritjes së tyre ishte i njëjtit. Të njëjtin konkluzion arritën dhe Zadavec et al (2013), të cilët bazuar në ditët pas lulëzimit të plote, realizuan një parashikim të hershem të diametrit dhe peshës përfundimtare të kokrrave në katër kultivarëve molle, duke përcaktuar dhe kohën me të përshtatshme për realizimin e këtij parashikimi për secilin kultivar. Studiues të tjerë në punimet e tyre kanë realizuar parashikime të hershme të diametrit dhe peshës së përfundimtare frutave të mollës nëpërmjet përdorimit të modeleve të ndryshme të rritjes, sic ishte ai i tipit polinom i shkallës së parë, të dytë dhe të tretë (Child Zepeda, 1987), logjistik (Bramadi, et al., 1997; Garritz et al., 1993) dhe logaritmik (Bajter et al., 1957). Kështu Ortega – Farias et al., (1997; 1998) duke përdorur modelin logjistik arritën një shkallë parashikimi shumë të lartë, me koeficient të përcaktueshmërisë ( $R^2$ ) mbi 0.9. Ndërsa Berg dhe Lötze (2006) realizuan parashikimin e suksesshëm të diametrit përfundimtar të kultivarit “Golden Delicious” me një nivel të lartë saktësie duke përdorur modelin logaritmik.

### **1.5.2. PËRCAKTIMI I PJEKJES SË FRUTIT TË MOLLES**

Përcaktimi i momentit me të përshtatshëm të vjeljes të secilit kultivar molle varet shumë nga destinacioni i tij, pra nëse do të përdoret për konsum të menjëhershëm, magazinim afatshkurtër apo afatgjatë (mbi 6 muaj) frigoriferik. Kështu mollët për magazinim afatgjatë duhet të vilen në atë stad të pjekjes së tyre kur ka ndodhur maturimi i plote i frutit, por nuk ka filluar ende procesi i prodhimit të vrullshëm të etilenit dhe frymëmarrja është në ritme të ulëta (Little dhe Holmes 2000). Kjo periudhë që quhet dhe dritarja e vjeljes së kultivarit për ruajtje afatgjatë zgjat disa dite (Blanpied dhe Silsby 1992). Kur mollët vilen para këtij afati, frutat janë më të vegjël, kanë ngjyrim dhe aromë të pakët dhe janë më të ndjeshëm ndaj djegies sipërfaqësore, kalbëzimit të hidhur e çrregullimeve të brendshme në ruajtje (Blanpied dhe Silsby 1992). Edhe humbjet në peshën e çdo kokrrë nga evaporimi gjatë magazinimit janë më të mëdha, sepse shtresa dyllore dhe kutikula në sipërfaqen e tyre nuk janë formuar plotësisht (Zerbini et al., 1999; Juan et al., 1999). Nga ana tjetër, kur mollët vilen më vonë se afati optimal, frutat nuk ruhen mirë gjatë magazinimit, zbuten shpejt, krijohen aroma jo karakteristike dhe janë shumë të ndjeshme ndaj sëmundjeve e kalbëzimeve. Për këtë arsye përcaktimi i periudhës optimale të vjeljes për ruajtjen afatgjatë të çdo kultivari është një proces shumë i rëndësishëm (Faragher et al., 1984). Ndryshe prej tyre, mollët e destinuara për ruajtje afatshkurtër ose konsum të menjëhershëm mund të vilen në stadi të mëvonshme të pjekjes.

Studimet kane treguar se ecuria e treguesve të pjekjes së frutave të mollës ndryshon jo vetëm nga kultivari në kultivar, por dhe nga nënshartesa e agroteknika e përdorur, gjendja e elementeve ushqimore në frut dhe veçanërisht e kalciumit (Ca), ngarkesa me fruta dhe pozicioni i tyre në peme, etj. Larmia dhe ndërveprimi i faktorëve të mësipërm nxjerrin në pah nevojën e vlerësimit të pjekjes së frutave për çdo kultivar dhe pemëtore (Little dhe Holmes 2000). Tendenca rritëse në ritmin e frymëmarrjes dhe prodhimit të etilenit në frutat e mollës është një karakteristikat baze që tregon se ato kane hyre në periudhën klimakterike të pjekjes. Ndonëse matja e dinamikës së prodhimit të etilenit dhe gazit karbonik do të ishte një tregues shumë i sakte i në vlerësimin e procesit të pjekjes së frutave, në kushtet e prodhimit të gjere kjo do të ishte tepër e vështire edhe në vendet e zhvilluara (Golding dhe Jobling, 2012).

Për këtë arsye, përpjekjet kane vazhduar për të identifikuar metoda më të thjeshta që mund të realizohen pa kërkuar kosto e kualifikime të veçanta për kultivuesit e mollës. Disa prej tyre jepen me poshtë:

a) **Datat kalendarike të vjeljes**

Përdoren gjerësisht nga kultivuesit me eksperience të mollës dhe kane në themel të tyre datat e lulëzimit të secilit kultivar dhe periudhat relativisht konstante të zhvillimit të frutave nga lulëzimi në pjekje (Little dhe Holmes, 2000). E kombinuar me matjen e treguesve të tjerë si fortësia dhe treguesi i amidonit në frut kjo metode rezulton mjaft e sakte.

b) **Ndryshimet në ngjyrimin e frutit**

Këto ndryshime përdoren si vlerësues të pjekjes në disa kultivarë me ngjyre jo të kuqe të mollës, të tilla si Granny Smith, Golden Delicious, etj. Megjithatë, rezultatet bindëse me këtë metode kërkojnë përdorimin e aparaturave të posaçme. Studime kane treguar se ka patur raste kur kushtet klimatike dhe të kultivimit mund të kenë ndikim në ngjyrimin e frutit por jo në pjekurinë e tij, prandaj kjo metode duhet të jete e kombinuar me matjen e treguesve të tjerë të pjekjes.

c) **Fortësia e frutit në pjekje**

Fortësia është një tregues i rëndësishëm dhe karakteristik për secilin kultivar molla. Megjithatë, disa faktorë të tilla si kushtet klimatike, të ushqyerit dhe përmasat e frutit rritin ndryshueshmërinë e këtij treguesi (Johnston et al., 2002, 2005), prandaj edhe ai duhet të kombinohet me matjen e treguesve të tjerë.

d) **Përmbajtja e lendeve të tretshme në frut**

Kjo realizohet nëpërmjet matjes së tyre me refraktometër është ndër metodat më të hershme të vlerësimit të pjekjes së frutave. Por vlerat e këtij treguesi mund të kenë luhate të mëdha nga pemëtorja në pemëtore, bile dhe ndërmjet drurëve të një pemëtore, varësisht nga disponueshmëria e ujit në toke, të ushqyerit mineral,



kushtet e motit dhe pozicioni i frutit në peme (Little & Holmes 2000). Përdorimi veçmas i këtij treguesi nuk jep rezultate të sakta.

e) **Niveli i amidonit në frut**

Ky nivel është një ndër faktorët kryesorë që ndikon në jetëgjatësinë e mollës në magazinim (Wills et al. 2007). Amidoni përbën karbohidratit e magazinuar gjatë rritjes së frutit, i cili zërthehet në sheqerna me të thjeshtë gjatë fazës së pjekjes. Përdorim të gjere ka gjetur metoda e provës së amidonit me jod, që bazohet në reaksionin ndërmjet amidonit dhe jodit dhe formimit të ngjyrës blu në të kuqe në tulin e mollës të prere sipas planit ekuatorial. Intensiteti i ngjyrës dhe shpërndarja në frut krahasohen me tabelat standarde të shkallëzuara. Edhe ky tregues është i ndjeshëm nga faktorët mjedisore dhe ujitja, prandaj përdorimi i tij veçmas nuk këshillohet.

f) **Treguesit e integruar të pjekjes**


Treguesit e integruar përfaqësojnë kombinimin e matjeve të disa veçorive fiziologjike e treguesve të pjekjes të frutit që mund të vlerësonin në mënyre me të sakta shkallen e pjekjes së tij. Në shumicën vendeve të Bashkimit Europian por dhe me gjere, që nga mesi i viteve 1990 e në vazhdim përdorim të gjere ka gjetur Indeksi Streif. Ky Indeks del nga raporti ndërmjet fortësisë së frutit me totalin e lëndëve të tretshme dhe treguesin e amidonit (Streif, 1983, 1996). Indeksi Streif përdoret masivisht në vlerësimin e kohës optimale të vjeljes të kultivarëve të mollës në Gjermani (Streif, 1996; Wilcke, 1996), në Hollande (de Jager dhe Roelofs, 1996), në Hungari (Merész et al., 1996), në Poloni (Rutkowski et al., 1996) dhe në vende të tjera. Studimet e kryera në vende të ndryshme kanë treguar se vlera e Indeksit Streif është thuhet unike për secilin kultivar ose grup kultivarësh dhe ndikohet shumë pak nga kushtet klimatike të vitit dhe faktorë të tjerë që kanë lidhje me agrotekniken e përdorur në pemëtoret e veçanta (Streif, 1996). Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, por dhe në Kanada, treguesit e integruar të pjekjes janë disa dhe kombinimet e tyre përcaktohen në varësi të kultivarit të mollës.

## 2. MATERIALI DHE METODA

### 2.1. TË DHENA PËR VENDOSJEN E STUDIMIT

- Vitet e kryerjes së studimit: 2012; 2013
- Vendndodhja e parcelës: Komuna Drenove
- Koordinatat dhe e parcelës: 40° 35' 35" V dhe 20° 45' 52" L
- Lartësia mbi nivelin e detit: 885 m
- Distanca nga qyteti i Korçës: 3 km
- Distanca nga Stacioni Meteorologjik i QTTB: 3.1 km
- Distanca nga rruga kombëtare Korçe – Erseke: 1 km
- Përmasat e pemëtores: 400 m x 180 m e ndare në 3 blloqe (Figura 2.1.)
- Sipërfaqja e parcelës dhe blloku ku u krye studimi: 0.6 Ha, blloku 3
- Tipi i tokës dhe tekstura e saj: Livadhore kafe, argjilore e mesme
- Indeksi i cilësisë së tokës (sipas Visual Soil Assessment): 18 (mesatar)
- pH: ujqor 6.8 pH kripor 6.6;
- Humusi 1.9%
- Permbajtja e azotit (N %): 0.120, e fosforit (mg P<sub>2</sub>O<sub>5</sub> për 100g toke): 1.4
- Kultivarët në parcele: Paragold, Janothan, Granny Smith, Red Chief dhe Golden Delicious.
- Kultivarët e marre në studim dhe nënshartesat: Golden Delicious, Red Chief dhe, Granny Smith mbi MM106, secili kultivar në rresht me vete, mbjelle në vitin 2002
- Drejtimi i rreshtave në parcele: Lindje - Perëndim
- Distanca e bimëve në rresht: 3.75 x 1.4 m
- Tipi i kurorës : Palmete me sistem mbështetës me tela
- Ujitja me pika me tuba impianti të vendosur në sipërfaqen e tokës.
- Plehërimi baze në muajin Mars duke shpërndare mes bimëve në rresht e 6 kv/ha pleh kompleks me përmbajtje N/P/K në raportet 12/11/18 dhe mikroelemente
- Plehërimi plotësues 3 here në vegjetacion nëpërmjet ujitjes në dozën totale 2 kv/ha me pleh kompleks N/P/K në raportet 20/20/20 dhe me mikroelementet Bor (B), Baker (Cu), Hekur (Fe), Mangan (Mn), Molibden (Mo) dhe Zink (Zn).
- Toka e mbajtur e pa punime me krahë ose mekanike, vetëm me herbicidim (përdorimi i herbicidit Roundup) dhe kositje bari gjate periudhës së vegjetacionit, duke e lënë atë në parcele.
- Rrallimi i frutave 40 – 50 dite pas lulëzimit të plote duke siguruar nje ngarkese në fruta për çdo cm<sup>2</sup> të prerjes tërthore të trungut prej: 9 – 9. 2 në kultivarët Golden Delicious dhe Red Chief dhe 6 - 6.5 tek Granny Smith.

- Mbrojtja nga sëmundje dëmtuesit bazuar në parimet e mbrojtjes së integruar, duke realizuar rreth 15 trajtime me kimikate në vit.



**Figura 2.1. Planimetria e pemëtores ku u krye studimi**

Për të realizuar tri objektivat e para të qëllimit të këtij studimi dyvjeçar, në fillim të muajit Maj 2012 për secilin nga të tre kultivarët: Golden Delicious, Red Chief dhe Granny Smith, në rreshtat përkatës të tyre u përzgjedhën në mënyre të rastësishme 5 peme, me rritje normale dhe të shëndetshme.

Për çdonjërin nga kultivarët e sipërpërmendur, në vitin 2012 dhe 2013 u regjistruan datat e fillimit të lulëzimit dhe lulëzimi i plote i tyre. Përcaktimi i datave të lulëzimit të plote u bë me vlerësim vizual, kur rreth 75 – 80 % e luleve në pemët e përzgjedhura të ishin plotësisht të çelura.

Dyzet dite pas lulëzimit të plote të çdo kultivari, në secilën nga të pese pemët e përzgjedhura u etiketohen në mënyre rastësore 40 fruta molle (200 gjithsej) në lartësinë 1.2 – 2 m mbi tokë, në të katër drejtimet e horizontit, nga jashtë – brenda kurorës.

Matjet e diametrit ekuatorial dhe gjatësor të secilit frut të etiketuar u realizuan me një kalibër elektronik të markës Teco, modeli SR44, me saktësi matje deri në 0.01mm. Para çdo matje saktësia e matjes së kalibrimit verifikohet sipas manualit shoqërues të këtij instrumenti (Foto 2.1.).

Matja e pare e diametrit u realizua 40 dite pas lulëzimit të plote (DPLP) të secilit kultivar e në vazhdim deri në vjelje, një here në shtate dite. Për kultivarët Golden Delicious dhe Red Chief u kryen gjithsej 17 matje, ndërsa për kultivarin Granny Smith 18 matje.



**Foto 2.1. Matja e diametrit të frutave me kalibër elektronik**

Të dhënat e matjeve për secilin kultivar u mbajtën në faqe të veçanta të programit Excel, në formën e një regjistri elektronik.

Në secilin vit të studimit, pas vjeljes, përpara se të behej përpunimi statistikor i këtyre të dhënave për secilin kultivar, rreshtat me të dhënat e matjeve u grupuan në drejtimin rritës në lidhje me madhësinë e diametrit ekuatorial të matur 40 DPLP, pra duke filluar nga diametri me i vogël ekuatorial në këtë date, tek me i madhi. Në këtë grupim, secili diametër ekuatorial shoqërohej gjithmonë në kolonën ngjitur nga diametri gjatësor përkatës. Në foton 2.2. jepet nje pjese e regjistrit elektronik për kultivarin Red Chief.

Për të mundësuar minimizimin e gabimit në parashikimin e diametrave të rritjes, tërësia e vlerave të diametrave ekuatoriale të grupuar të secilit kultivar në 40 DPLP u nda në intervale madhësish me diference 2 mm nga njeri tjetri.

|    | Q          | R     | S        | T     | U        | V     | W          | X     | Y        | Z     | AA         | AB    | AC       | AD    | AE       | AF    | AG         | AH    | AI |
|----|------------|-------|----------|-------|----------|-------|------------|-------|----------|-------|------------|-------|----------|-------|----------|-------|------------|-------|----|
| 1  | 31.07.2013 |       | 07.08.13 |       | 14.08.13 |       | 21.08.2013 |       | 28.08.13 |       | 04.09.2013 |       | 11.09.12 |       | 18.09.13 |       | 25.09.2013 |       |    |
| 2  | De         | Dgj   | De       | Dgj   | De       | Dgj   | De         | Dgj   | De       | Dgj   | De         | Dgj   | De       | Dgj   | De       | Dgj   | De         | Dgj   |    |
| 3  | 64.66      | 63.01 | 69.19    | 66.16 | 71.95    | 68.80 | 74.83      | 70.87 | 77.62    | 72.56 | 79.43      | 73.62 | 80.62    | 74.66 | 81.88    | 74.84 | 82.14      | 75.41 |    |
| 4  | 64.72      | 63.18 | 69.25    | 66.34 | 72.02    | 69.00 | 74.91      | 71.07 | 77.70    | 72.76 | 79.51      | 73.83 | 80.70    | 74.87 | 81.96    | 75.05 | 82.22      | 75.62 |    |
| 5  | 64.74      | 63.12 | 69.28    | 66.28 | 72.05    | 68.93 | 74.93      | 71.00 | 77.72    | 72.69 | 79.54      | 73.76 | 80.72    | 74.80 | 81.99    | 74.98 | 82.25      | 75.55 |    |
| 6  | 64.79      | 63.28 | 69.32    | 66.45 | 72.09    | 69.10 | 74.98      | 71.18 | 77.78    | 72.87 | 79.59      | 73.94 | 80.77    | 74.99 | 82.04    | 75.17 | 82.30      | 75.74 |    |
| 7  | 64.85      | 63.14 | 69.39    | 66.30 | 72.17    | 68.95 | 75.05      | 71.02 | 77.85    | 72.71 | 79.67      | 73.78 | 80.85    | 74.83 | 82.12    | 75.00 | 82.38      | 75.57 |    |
| 8  | 64.93      | 63.40 | 69.48    | 66.57 | 72.26    | 69.23 | 75.15      | 71.31 | 77.95    | 73.01 | 79.77      | 74.08 | 80.96    | 75.13 | 82.23    | 75.31 | 82.49      | 75.88 |    |
| 9  | 64.96      | 63.30 | 69.50    | 66.47 | 72.28    | 69.12 | 75.17      | 71.20 | 77.98    | 72.89 | 79.80      | 73.96 | 80.99    | 75.01 | 82.25    | 75.19 | 82.51      | 75.76 |    |
| 10 | 65.04      | 63.48 | 69.59    | 66.65 | 72.38    | 69.32 | 75.27      | 71.40 | 78.08    | 73.10 | 79.90      | 74.17 | 81.09    | 75.22 | 82.36    | 75.40 | 82.62      | 75.97 |    |
| 11 | 65.08      | 63.46 | 69.64    | 66.63 | 72.42    | 69.30 | 75.32      | 71.37 | 78.13    | 73.08 | 79.95      | 74.15 | 81.14    | 75.20 | 82.41    | 75.38 | 82.67      | 75.95 |    |
| 12 | 65.10      | 63.61 | 69.66    | 66.80 | 72.45    | 69.47 | 75.34      | 71.55 | 78.15    | 73.26 | 79.98      | 74.33 | 81.17    | 75.38 | 82.44    | 75.56 | 82.70      | 76.14 |    |
| 13 | 65.19      | 63.44 | 69.75    | 66.61 | 72.54    | 69.27 | 75.44      | 71.35 | 78.26    | 73.05 | 80.08      | 74.12 | 81.27    | 75.18 | 82.55    | 75.35 | 82.81      | 75.93 |    |
| 14 | 65.21      | 63.79 | 69.77    | 66.98 | 72.56    | 69.66 | 75.47      | 71.75 | 78.28    | 73.46 | 80.11      | 74.54 | 81.30    | 75.59 | 82.57    | 75.77 | 82.84      | 76.35 |    |
| 15 | 65.25      | 63.71 | 69.82    | 66.90 | 72.61    | 69.57 | 75.52      | 71.66 | 78.33    | 73.37 | 80.16      | 74.44 | 81.35    | 75.50 | 82.63    | 75.68 | 82.89      | 76.25 |    |
| 16 | 65.27      | 63.75 | 69.84    | 66.94 | 72.63    | 69.62 | 75.54      | 71.71 | 78.36    | 73.41 | 80.18      | 74.49 | 81.38    | 75.55 | 82.65    | 75.73 | 82.92      | 76.30 |    |
| 17 | 65.31      | 63.69 | 69.89    | 66.88 | 72.68    | 69.55 | 75.59      | 71.64 | 78.41    | 73.35 | 80.24      | 74.42 | 81.43    | 75.48 | 82.71    | 75.66 | 82.97      | 76.23 |    |
| 18 |            |       |          |       |          |       |            |       |          |       |            |       |          |       |          |       |            |       |    |
| 19 | 65.1       | 63.48 | 69.68    | 66.64 | 72.48    | 69.21 | 75.23      | 71.34 | 78.04    | 73.04 | 79.86      | 74.11 | 81.05    | 75.16 | 82.32    | 75.34 | 82.58      | 75.91 |    |

**Foto 2.2. Regjistri elektronik për kultivarin Red Chief me diametrat e grupuar**

Temperatura minimale dhe maksimale ditore si dhe reshjet për të dy vitet në periudhën Prill – Tetor u morën nga stacioni meteorologjik i Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqesore Korçë, në nje distance prej 3.1 km nga pemëtorja.

Përllogaritja e temperaturës ditore të rritjes për çdo dite, nga lulëzimi i plote deri në vjelje, u përllogarit me formulën e mëposhtme:

$$T = \frac{T_{min} + T_{max}}{2} - 10$$

Ku:

T = Temperatura ditore e rritjes

Tmin = Temperatura minimale ditore (°C);

Tmax = Temperatura maksimale ditore (°C);

10 = pragu i temperaturës me të ulet të rritjes (10°C).

## 2.2. PËRCAKTIMI I EKUACIONIT ME TË PËRSHTATSHËM TË REGRESIONIT PËR RITJEN E DIAMETRAVE EKVATORIALE DHE GJATËSORË TË FRUTAVE NË FUNKSION TË SHUMES TË TEMPERATURAVE DITORE TË RITJES

Për të përzgjedhur ekuacionin me të përshtatshëm të regresionit që përshkruan marrëdhënien ndërmjet rritjes së secilit grup diametrash dhe shumes së temperaturave ditore të rritjes ( $\Sigma T$ ) nga 40 DPLP deri në vjelje, u krahasuan mes tyre tri modele ekuacionesh regresioni polinomiale: linear, kuadratik dhe kubik (Foto 2.3).

Përzgjedhja e këtyre modeleve ekuacionesh u bë sepse ata konsiderohen me të përshtatshmit për të shprehur marrëdhënien ndërmjet dy variabla të vazhduara, diametrit dhe shumes së temperaturave (Minitab 16.1. – Fitted Line Plot), e cila mund të jete:

- Lineare, kur rritja e diametrit është në përpjesëtim të drejte me temperaturën,
- Kuadratike, kur me rritjen e temperaturës ulet ritmi i rritjes së diametrit
- Kubike, kur grafiku i rritjes i përngjan atij të një ekuacioni të fuqisë së trete

Nga ana matematikore të tre modelet e sipërpërmendura mund të shprehen si me poshtë:

- Modeli linear si ekuacion i shkallës së parë:

$$D = b_0 + b_1 * \Sigma T$$

- Modeli kuadratik si ekuacion i shkallës së dytë:

$$D = b_0 + b_1 * \Sigma T + b_2 * \Sigma T^2$$

- Modeli kubik si ekuacion i shkallës së tretë:

$$D = b_0 + b_1 * \Sigma T + b_2 * \Sigma T^2 + b_3 * \Sigma T^3$$

Ku:

D = diametri ekuatorial ose gjatësor i frutave të mollës;


$b_0$  = diametri i frutit (ekuatorial ose gjatësor) kur vlera e  $\Sigma T$  është zero ( $0^{\circ}\text{C}$ );

$\Sigma T$  = shuma e temperaturave ditore të rritjes në secilin ekuacion fillonte me vlerën  $0^{\circ}\text{C}$  në 40 DPLP, dhe me pas rritej në mënyre kumulative sipas ecurisë të saj nga njëra matje tek tjetra deri në vjelje.

$b_1, b_2, b_3$  = koeficiente që tregojnë ndryshimin në mesataren e diametrit (ekuatorial ose gjatësor) të frutit të mollës kur  $\Sigma T$  rritet me njësi ( $1^{\circ}\text{C}$ ).

\* = shenja e veprimit të shumëzimit

^ = shenja e ngritjes në fuqi



**Foto 2.3. Krahasimi i tre modeleve të regresionit për rritjen e diametrave**


Përpunimi i të gjithë të dhënave u bë me programin statistikor Minitab 16.1 (Statistics - Regression - Fitted Line Plot), me nivel besueshmërie 95%. Ekuacioni me i përshtatshëm për secilin grup diametrash u cilësua ai që kishte Koeficientin e Përshtatshmërisë ( $R^2$ ) me të lartë dhe Deviacionin Standard me të ulët (Minitab 16.1 – Assistant) .

### **2.3. PËRPILIMI I TABELAVE PARASHIKUESE TË RRRITJES SË DIAMETRAVE NË FUNKSION TË SHUMES SË TEMPERATURAVE DITORE TË RRRITJES**

Për të përgatitur tabelat parashikuese të rritjes të diametrit ekuatorial dhe gjatësor në funksion të  $\Sigma T$ , në secilin nga ekuacionet e regresionit të përzgjedhur si me i përshtatshmi në përshkrimin e marrëdhënies ndërmjet rritjes së secilit grup diametrash dhe shumës së temperaturave ditore të rritjes ( $\Sigma T$ ), për kultivarët Golden Delicious dhe Red Chief ju dhanë vlerat fikse duke filluar nga  $\Sigma T=100^{\circ}\text{C}$ ;  $\Sigma T=150^{\circ}\text{C}$ ;  $\Sigma T=200^{\circ}\text{C}$ ....  $\Sigma T=1350^{\circ}\text{C}$  (Foto 2.4.).

Për kultivarin Granny Smith shumës së temperaturave ditore të rritjes ( $\Sigma T$ ) ju dhanë të njëjtat vlera si tek dy kultivarët e tjerë, por kufiri i sipërm i tyre shkoi në  $\Sigma T=1400^{\circ}\text{C}$ .

Të dhënat e dala pas përlllogaritjeve u hodhën në tabelat parashikuese për secilin kultivar.



|    | A   | B           | C               | D | E | F |
|----|---|-------------|-----------------|---|---|---|
| 1  | Ekuacioni i regresionit i perzgjedhur                     | Temp. fikse | Vlera e De (mm) |   |   |   |
| 2  | $De = 26.79 + 0.05663 * \Sigma T - 0.000019 * \Sigma T^2$ | 0           | 26.76           |   |   |   |
| 3  |   | 100         | 32.26           |   |   |   |
| 4  |   | 150         | 34.86           |   |   |   |
| 5  |   | 200         | 37.36           |   |   |   |
| 6  |   | 250         | 39.76           |   |   |   |
| 7  |   | 300         | 42.07           |   |   |   |
| 8  |   | 350         | 44.28           |   |   |   |
| 9  |   | 400         | 46.4            |   |   |   |
| 10 |   | 450         | 48.43           |   |   |   |
| 11 |   | 500         | 50.36           |   |   |   |
| 12 |   | 550         | 52.19           |   |   |   |

Foto 2.4. Diametri në vlera fikse të shumës të temperaturave të rritjes ( $\Sigma T$ )

## 2.4. PËRLLLOGARITJA E EKUACIONEVE TË REGRESIONIT QË SHPREHIN MARRËDHËNIEN NDËRMJET PESHËS SË FRUTAVE NË FUNKSION TË DIAMETRAVE EKUATORIALE DHE GJATËSORE TË TYRE

Për të realizuar parashikimin e hershem të peshës përfundimtare të frutave në vjelje, të gjithë kokrrat e mollëve të etiketuara të secilit kultivar, të mbetura në peme deri në momentin e vjeljes, pasi u volën dhe ju maten diametrat e tyre përfundimtare, u peshuan me vete me një peshore elektronike të markës AUY, modeli F 2000, me saktësi matje deri në 0,1g (Foto 2.5.)

Të dhënat e peshës së tyre u hodhën në regjistrin elektronik, përbri diametrave përkatës.

Me këto të dhëna, duke përdorur si variabla të pavarura vlerat e diametrave ekuatoriale dhe gjatësore në vjelje në 152 DPLP për Golden Delicious dhe Red Chief dhe 159 DPLP për Granny Smith dhe peshën e frutit në vjelje si një variabël të varur, u përlllogariten ekuacionet e shumëfishta të regresionit për secilin grup diametresh të tre kultivarëve, në formën:

$$P = b_0 + b_1De + b_2Dgj$$

Ku:

$P$  = pesha e frutit në gram;

$b_0$  = koeficient konstant i ekuacionit të regresionit;

$De$  dhe  $Dgj$  = përkatësisht diametri ekuatorial dhe gjatësor i frutit

$b_1$  dhe  $b_2$  = koeficiente që tregojnë ndryshimin në peshën e frutit kur vlerat e  $De$  dhe  $Dgj$  rriten me një njësi (1 mm)

Për të nxjerre në pah saktësinë e çdo ekuacioni të shumëfishte të regresionit, u vlerësuan dy parametra kryesore të tyre: Koeficienti i Përcaktueshmërisë ( $R^2$ ) dhe Deviacion Standard (DS) (Minitab 16.1 –



Regression).

Ekuacioni i shumëfishtë i regresionit si me sipër u përdor gjithashtu dhe për parashikimin e peshës së frutave në datat me të hershme se ajo e vjeljes të tyre. Kjo u realizua nëpërmjet vendosjes në ekuacion të vlerave të diametrave ekuatoriale dhe gjatësorë në secilën nga këto data.

Për kultivarët Golden Delicious dhe Red Chief u përlogarit pesha e frutave në 131, 138 dhe 145 DPLP, ndërsa për Granny Smith në 138, 145 dhe 152 DPLP. Për të evidentuar dinamikën e rritjes së peshës nga njëra matje tek tjetra deri në vjelje, peshës përfundimtare të frutit në vjelje për çdo grup diamettrash ju zbrit pesha përkatëse në datat me të hershme të matjeve.

Përpunimi i të dhënave u bë me programin statistikor Minitab 16.1 (Statistics – Regression – Regression), me nivel besueshmërie 95%.



Foto 2.5. Peshimi i frutave të porsavjele

## **2.5. PËRCAKTIMI I PERIUDHËS SË VJELJES BAZUAR NË TREGUESIT E PJEKJES SË FRUTAVE**

Në të dy vitet e studimit, për secilin nga të tre kultivarët Golden Delicious, Red Chief dhe Granny Smith u bë ndjekje e ecurisë së tre treguesve të pjekjes së frutave:

- Fortësisë
- Totalit të lendeve të tretshme
- Treguesit të amidonit

Për kultivarët Golden Delicious dhe Red Chief për këta tregues u bëne gjithsej gjashtë matje, në intervale kohore 5 ditore nga njëri tjetri, duke filluar nga 130 –

150 DPLP (pese matje) dhe matja e gjashte në vjelje, 152 DPLP. Ndërsa për kultivarin Granny Smith u bene gjithsej shtate matje në intervale 5 ditore, duke filluar nga 130 – 155 DPLP (gjashte matje), ndërsa matja e shtate në vjelje, 159 DPLP.

Për secilin kultivar dhe për çdo date matje, mostra u përgatit duke marre nga katër fruta në pese pemë brenda rreshtit përkatës të kultivarit (gjithsej 20 fruta), të vendosura në mesin e lartësisë së kurorës, nga nje frut për çdo drejtim të horizontit, duke shmangur frutat e dëmtuar dhe të deformuar.

Për matjen e treguesve të pjekje u zbatuan procedurat e mëposhtme:

- Matja e **Fortësisë së frutave** e shprehur në kg/cm<sup>2</sup> u krye me nje penetrometër dore të tipit Wagner FT 30, me tub sonde 11 mm, duke bere shpime në të dy anët e kundërta të kokrrës për të nxjerrë mesataren e fortësisë për çdo kokërr.

- **Totali i Lëndëve të Tretshme** në frut i vlerësuar në °Briks u mat me nje refraktometër dore të tipit ATC REF-114, duke marre veçmas lëng nga secila kokërr. Refraktometri u ri-kalibrua pas çdo matje sipas procedurave të përshkruara në manualin e tij.

- **Treguesi i Amidonit** u realizua nëpërmjet zhytjes për 30 sekonda të gjysmë kokrrave të mollës të prera sipas planit ekuatorial në tretësirë Kalium Jodi (KI) dhe Jod (I) që përmbante për çdo litër tretësirë 10 gr kristale të tretura të Kalium Jodit dhe 3 gr kristale Jodi. Vlerësimi i shndrimit të amidonit në sheqerna të thjeshtë u bë nëpërmjet krahasimit të njollosjes së çdo kokrre me tabelat standarde të shkallës 1 -10, ku 1 përfaqëson 0% shndrim amidoni, ndërsa 10 tregon 100% shndrim të tij në sheqerna të thjeshtë. Bazuar në karakteristikat e njollosjes me jod, për vlerësimin e Treguesit të amidonit, kultivarët Golden Delicious dhe Granny Smith u përdor tabela e njollosjes rrezore (Figura 2.2.), ndërsa për Red Chief tabela e njollosjes rrethore (Figura 2.3.).

Mbi bazën e tre treguesve të mësipërm (fortësisë, totalit të lendeve të tretshme dhe treguesit të amidonit) u be përlllogaritja e Indeksit Streif, sipas formulës:

$$\text{Indeksi Streif} = \frac{\text{Fortesia}}{\text{Totali i Lendeve të Tretshme} \times \text{Treguesi i Amidonit}}$$

Të gjithë të dhënat nga matjet u përpunuan me programin statistikor MINITAB 16.1, me nivel besueshmërie 95%. Të gjitha mesataret të treguesve të pjekjes nga njëra matje tek tjetra ju nënshtruan testit të Fisherit për të vërtetuar nëse për p < 0.05 kishin mes tyre diferenca statistikisht të vërtetuara.

Bazuar në të dhënat e literaturës, u krye vlerësimi i datave me të përshtatshme të vjeljes për ruajtjen afatgjate frigoriferike të secilit kultivar.




Figura 2.2. Njolloosja rrezore për Golden Delicious dhe Granny Smith



TABELA E SHNDRIMIT TE AMIDONIT NE SHEQERNA TE THJESHTE

NJOLLOSJA QARKORE (C)



1 (C)

*Slight central discolouration*



2(C)



3(C)



4(C)

*Central discolouration, from "coin" to "5-leaved clover"*



5(C)



6(C)



7(C)

*Increasing central discolouration with peripheral spots*



8(C)



9(C)



10(C)

*Increasing peripheral discolouration*

Figura 2.3. Njolllosja rrethore për Red Chief

### 3. REZULTATET DHE DISKUTIMI

#### 3.1. KULTIVARI GOLDEN DELICIOUS

Në dy vitet e studimit, datat e lulëzimit të plotë të kultivarit Golden Delicious ishin 4 Maj 2012 dhe 27 Prill 2013. Sipas metodikes, matja e pare e diametrit ekuatorial dhe gjatësor të 200 frutave të etiketuara u krye 40 dite pas lulëzimit të plote (DPLP), në datat 13 Qershor 2012 dhe 6 Qershor 2013 (Tabela 3.1 dhe Tabela 3.2)

**Tabela 3.1. Frutat e Golden Delicious sipas diametrave ekuatoriale në 40 DPLP**

| Viti | 25–27 mm  |                  | 27-29 mm  |                  | 29-31 mm  |                  | 31-33 mm  |                  | 33–35 mm  |                  |
|------|-----------|------------------|-----------|------------------|-----------|------------------|-----------|------------------|-----------|------------------|
|      | Nr. fruta | D <sub>mes</sub> | Nr. fruta | D <sub>mes</sub> | Nr. fruta | D <sub>mes</sub> | Nr. fruta | D <sub>mes</sub> | Nr. fruta | D <sub>mes</sub> |
| 2012 | 48        | 26.76            | 152       | 28.07            | -         | -                | -         | -                | -         | -                |
| 2013 | -         | -                | -         | -                | 76        | 30.02            | 55        | 31.94            | 69        | 33.58            |

Nga të dhënat e Tabelës 3.1 rezulton se dyqind frutat e vitit 2012 kishin diametra ekuatoriale në dy intervale madhësish: 25 - 27 mm e 27 – 29 mm, ndërsa ato të vitit 2013 në tri intervale me të mëdha: 29 – 31 mm, 31 – 33 mm dhe 33 – 35 mm.

**Tabela 3.2. Frutat e Golden Delicious sipas diametrave gjatësorë në 40 DPLP**

| Viti | 27–31 mm  |                  | 30–33 mm  |                  | 32 – 36 mm |                  | 33 – 38 mm |                  | 35 – 38 mm |                  |
|------|-----------|------------------|-----------|------------------|------------|------------------|------------|------------------|------------|------------------|
|      | Nr. fruta | D <sub>mes</sub> | Nr. fruta | D <sub>mes</sub> | Nr. fruta  | D <sub>mes</sub> | Nr. fruta  | D <sub>mes</sub> | Nr. fruta  | D <sub>mes</sub> |
| 2012 | 48        | 30.37            | 152       | 31.71            | -          | -                | -          | -                | -          | -                |
| 2013 | -         | -                | -         | -                | 76         | 33.72            | 55         | 37.25            | 69         | 37.05            |

Ndërsa të dhënat Tabelës 3.2 tregojnë se edhe diametrat korrespondues gjatësorë në këto dy vite ishin të ndryshëm, ato të vitit 2012 i përkisnin dy grup intervaleve 27- 31 mm dhe 30 – 33 mm, ndërsa diametrat e vitit 2013 tri intervaleve: 32 – 36 mm, 33 – 38 mm dhe 35 – 38 mm.

Në krahasimin mes tyre të vlerave mesatare të diametrave ekuatoriale dhe gjatësorë të dy viteve në këtë matje të pare, rezultoi se ata të vitit 2013 ishin me të mëdhenj se sa ata të vitit 2012. Ekuatoriale të vitit 2013 ishin me të mëdhenj, ndërsa gjatësorët 3.87 mm, ndonëse ngarkesa me lule, planifikimi i ngarkesës me fruta nëpërmjet rrallimit, sikundër dhe shërbimet agroteknike, kishin qene të njëjta në të dy vitet.

Nje faktor ndikues i rëndësishëm që mund të shpjegoje këtë diference në madhësi diametrash është shuma e temperaturave ditore të rritjes të grumbulluara nga dita e lulëzimit të plote deri në 40 DPLP në secilin vit.

Në vitin 2012 për kultivarin Golden Delicious gjate kësaj periudhe u grumbulluan 158.2<sup>0</sup>C, ndërsa në vitin 2013 ato ishin 264.7<sup>0</sup>C, ose 106.50C me tepër.

Roli i temperaturave në fazën e pare të rritjes se frutave të mollës është argumentuar në studimet e Bergh (1990) dhe Warrington et al, (1999).

Matjet e tjera të diametrave vazhduan me intervale të njëjta kohore prej shtate ditësh nga njëra tjetra deri në vjeljen e frutave, në 152 DPLP. Në secilin vit u realizuan gjithsej 17 matje. Paralelisht me matjet e diametrave ekuatoriale dhe gjatësorë, bazuar në të dhënat nga Stacioni Meteorologjik i QTTB, u regjistruan të dhënat e temperaturave ditore të rritjes si dhe shuma e këtyre temperaturave rritje (ΣT) për çdo shtate ditor dhe në mënyrë progresive deri në vjelje

Megjithëse temperaturat ditore të rritjes nga dita e lulëzimit të plote deri në 40 DPLP u regjistruan me qëllim vlerësimin e shumes së tyre në rritjen e diametrave gjate kësaj periudhe, në datën e matjes së pare (40 DPLP) temperaturës ditore të rritjes ju dha vlera 0.0<sup>0</sup>C, dhe prej kësaj date e në vazhdim kjo temperaturë u kumulua çdo dite deri në vjelje (Tabela 3.3).

**Tabela 3.3. DPLP në datat korresponduese të tyre dhe ΣT për Golden Delicious**

| Viti 2012 |            |        | Viti 2013 |            |        |
|-----------|------------|--------|-----------|------------|--------|
| DPLP      | Data       | ΣT     | DPLP      | Data       | ΣT     |
| 40        | 13 Qershor | 0.0    | 40        | 6 Qershor  | 0.0    |
| 47        | 20 Qershor | 62.7   | 47        | 13 Qershor | 57.7   |
| 54        | 27 Qershor | 146.2  | 54        | 20 Qershor | 141.1  |
| 61        | 4 Korrik   | 230.4  | 61        | 27 Qershor | 223.6  |
| 68        | 11 Korrik  | 339.0  | 68        | 4 Korrik   | 285.3  |
| 75        | 18 Korrik  | 447.3  | 75        | 11 Korrik  | 365.8  |
| 82        | 25 Korrik  | 549.5  | 82        | 18 Korrik  | 450.1  |
| 89        | 1 Gusht    | 653.6  | 89        | 25 Korrik  | 531.0  |
| 96        | 8 Gusht    | 764.0  | 96        | 1 Gusht    | 644.1  |
| 103       | 15 Gusht   | 841.9  | 103       | 8 Gusht    | 758.3  |
| 110       | 22 Gusht   | 929.9  | 110       | 15 Gusht   | 854.7  |
| 117       | 29 Gusht   | 1036.9 | 117       | 22 Gusht   | 948.7  |
| 124       | 5 Shtator  | 1116.8 | 124       | 29 Gusht   | 1039.2 |
| 131       | 12 Shtator | 1183.3 | 131       | 5 Shtator  | 1108.0 |
| 138       | 19 Shtator | 1225.4 | 138       | 12 Shtator | 1175.1 |
| 145       | 26 Shtator | 1268.4 | 145       | 19 Shtator | 1233.4 |
| 152       | 3 Tetor    | 1333.8 | 152       | 26 Shtator | 1267.4 |

Në të dy vitet, në përfundim të 17 matjeve, diametrat ekuatorialë u radhitën në regjistrin elektronik njeri pas tjetrit në drejtimin e tyre rritës (nga diametri me i vogël tek me i madhi) bazuar në vlerat e tyre në 40 DPLP. Në këtë radhitje, secili diametër ekuatorial shoqërohej gjithmonë në kolonën ngjitur nga diametri gjatësor përkatës.

Për të mundësuar përllogaritje dhe parashikime me të sakta të dinamikës të rritjes të frutave, tërësia e vlerave të diametrave ekuatoriale u nda në grupe me intervale madhësish 2 mm nga njeri tjetri, në pese grupe gjithsej. Edhe diametrat gjatësorë korrespondues të tyre u radhitën në intervalet përkatëse.

Në tabelën 3.4 jepet tërësia e diametrave ekuatorialë dhe gjatësorë të grupuar në intervalet korrespondues për secilin vit të studimit, duke filluar nga 40 DPLP deri në vjelje (152 DPLP), për të 17 matjet e kryera.

**Tabela 3.4 Diametrat ekuatoriale e gjatësorë të Golden Delicious 40 – 152 DPLP**

| DPLP | Diametrat e grupuar (2012) |                  |                 |                  | Diametrat e grupuar (2013) |                  |                 |                  |                 |                  |
|------|----------------------------|------------------|-----------------|------------------|----------------------------|------------------|-----------------|------------------|-----------------|------------------|
|      | De <sub>1</sub>            | Dgj <sub>1</sub> | De <sub>2</sub> | Dgj <sub>2</sub> | De <sub>3</sub>            | Dgj <sub>3</sub> | De <sub>4</sub> | Dgj <sub>4</sub> | De <sub>5</sub> | Dgj <sub>5</sub> |
| 40   | 26.76                      | 30.37            | 28.07           | 31.71            | 30.02                      | 33.72            | 31.94           | 37.25            | 33.58           | 37.05            |
| 47   | 30.21                      | 33.55            | 32.33           | 35.24            | 34.12                      | 36.98            | 36.33           | 41.16            | 38.39           | 41.13            |
| 54   | 34.79                      | 36.61            | 37.01           | 38.92            | 38.86                      | 40.75            | 41.36           | 45.09            | 43.51           | 45.01            |
| 61   | 38.73                      | 40.39            | 41.05           | 42.04            | 44.46                      | 44.88            | 47.26           | 49.85            | 49.78           | 49.97            |
| 68   | 44.02                      | 43.68            | 46.87           | 46.37            | 47.96                      | 48.02            | 51.08           | 53.67            | 53.90           | 53.88            |
| 75   | 48.29                      | 47.24            | 51.38           | 50.79            | 52.43                      | 51.47            | 55.74           | 57.63            | 57.59           | 56.45            |
| 82   | 52.02                      | 50.96            | 55.84           | 53.66            | 55.98                      | 54.63            | 59.58           | 60.64            | 62.87           | 60.32            |
| 89   | 55.86                      | 53.53            | 59.52           | 56.85            | 60.31                      | 57.99            | 64.20           | 64.89            | 66.62           | 64.59            |
| 96   | 58.92                      | 55.54            | 63.39           | 59.93            | 64.23                      | 61.24            | 68.31           | 68.29            | 71.91           | 69.37            |
| 103  | 61.05                      | 57.68            | 65.43           | 61.97            | 67.84                      | 64.35            | 72.97           | 72.32            | 75.95           | 72.54            |
| 110  | 63.25                      | 59.31            | 68.07           | 63.62            | 70.98                      | 66.73            | 75.54           | 74.11            | 79.47           | 75.12            |
| 117  | 65.07                      | 60.75            | 69.94           | 65.40            | 73.76                      | 69.06            | 78.39           | 76.85            | 82.18           | 77.81            |
| 124  | 66.34                      | 61.46            | 71.75           | 66.46            | 75.79                      | 70.44            | 80.68           | 78.54            | 84.95           | 80.16            |
| 131  | 67.18                      | 61.77            | 72.79           | 67.93            | 77.25                      | 71.93            | 82.18           | 79.56            | 86.49           | 80.95            |
| 138  | 67.89                      | 62.09            | 73.08           | 68.27            | 77.81                      | 72.57            | 82.81           | 79.81            | 86.96           | 81.53            |
| 145  | 68.36                      | 62.51            | 73.77           | 68.62            | 78.63                      | 72.85            | 83.58           | 80.35            | 87.82           | 81.91            |
| 152  | 68.58                      | 62.93            | 74.08           | 68.93            | 79.27                      | 73.31            | 84.36           | 80.58            | 88.75           | 82.19            |

Sic del qarte nga Tabela 3.4, dinamika e rritjes së diametrave ka qene me e madhe në vlere absolute gjate periudhës së pare të rritjes së tyre, ndërsa duke filluar nga mesi i sezonit e në vazhdim ajo ka ardhur duke u ulur vazhdimisht deri në vjelje. Nga krahasimi i shifrave të rritjes së diametrave duket sikur frutat e kultivarit Golden Delicious reduktojnë rritjen nga fundi i muajit Korrik deri në vjelje. Por në fakt konstatojmë se gjate fazës së pare të rritjes të frutave, kur diametri i tyre

është i vogël, zmadhimi i tij me 1 mm mund të përfaqësojë shtesën në peshe prej me pak se 1 gram për frut, ndërsa pas mesit të sezonit të rritjes deri në vjelje, rritja e përmasave të tij me 1 mm do të shprehte në realitet disa gram shtese të frutit. Këto të dhëna përputhen me studimet bashkëkohore (Lakso dhe Goffinet, 2013).

### 3.1.1. PËRCAKTIMI I EKUACIONIT ME TË PËRSHTATSHËM TË REGRESIONIT QË SHPREH MARRËDHËNIEN NDËRMJET RITJES SË DIAMETRIT DHE SHUMES TË TEMPERATURAVE DITORE TË RITJES TË KULTIVARIT GOLDEN DELICIOUS.

Për të përcaktuar ekuacionin me të përshtatshëm të regresionit që shpreh marrëdhënien ndërmjet rritjes së diametrave ekuatoriale dhe gjatësorë dhe shumes të temperaturave ditore të rritjes për kultivarin Golden Delicious nga 40 DPLP deri 152 DPLP, vlerat e secilit diametër ekuatorial dhe gjatësor në Tabelën 3.4 u futën në formën e kolonave përkatëse në fletën e punës të programi statistikor Minitab 16.1. Sipas metodikës, u krahasuan mes tyre të tre modelet e ekuacioneve të regresionit:

- Modeli Linear (L),
- Modeli kuadratik (Q);
- Modeli kubik (K);




Foto 3.1. Përzgjedhja e modelit të ekuacionit të Golden Delicious për De 26.76 mm



Ekuacioni me i përshtatshëm do të ishte ai që kishte vlerën me të lartë të Koeficientit të Përcaktueshmërisë ( $R^2$ ) dhe vlerën me të ulët të Deviacionit Standard (DS). Përzgjedhja e ekuacionit me të përshtatshëm të regresionit u realizua nga krahasimi i njëkohshëm i tre modeleve në programin statistikor Minitab 16.1, ashtu sic ilustron në Grafikon 3.1. për diametrin ekuatorial të Golden Delicious  $De = 26.76$  mm.

Në Tabelën 3.5, për secilin nga të peste intervalet e diametrave ekuatorialë dhe për të tre modelet e ekuacionit të regresionit jepen vlerat e Koeficientit të Përcaktueshmërisë dhe Deviacionin Standard. Ndërsa në Tabelën 3.6 këto vlera jepen për diametrat përkatës gjatësore.

**Tabela 3.5. Krahasimi i tre modeleve të ekuacioneve për diametrat ekuatoriale**  
( $p < 0.05$ )

| De (mm)<br>40 DPLP | Model | Ekuacionet e regresionit për grup diametrat ekuatoriale                        | $R^2$<br>(%) | DS    |
|--------------------|-------|--|--------------|-------|
| 26.76<br>(25 – 27) | L     | $De = 31.77 + 0.03110 * \Sigma T$  | 95.49        | 3.037 |
|                    | Q     | $De = 26.79 + 0.05663 * \Sigma T - 0.000019 * \Sigma T^2$                      | 99.99        | 0.133 |
|                    | K     | $De = 26.77 + 0.05690 * \Sigma T - 0.000019 * \Sigma T^2 + 0.000 * \Sigma T^3$ | 99.99        | 0.137 |
| 28.07<br>(27 – 29) | L     | $De = 33.54 + 0.03414 * \Sigma T$  | 95.84        | 3.195 |
|                    | Q     | $De = 28.31 + 0.06097 * \Sigma T - 0.000020 * \Sigma T^2$                      | 99.98        | 0.204 |
|                    | K     | $De = 28.35 + 0.06049 * \Sigma T - 0.000019 * \Sigma T^2 - 0.000 * \Sigma T^3$ | 99.98        | 0.210 |
| 30.02<br>(29 – 31) | L     | $De = 35.91 + 0.03782 * \Sigma T$  | 95.82        | 3.406 |
|                    | Q     | $De = 30.20 + 0.06803 * \Sigma T - 0.000023 * \Sigma T^2$                      | 99.96        | 0.330 |
|                    | K     | $De = 29.97 + 0.07078 * \Sigma T - 0.000029 * \Sigma T^2 + 0.000 * \Sigma T^3$ | 99.96        | 0.335 |
| 31.94<br>(31 – 33) | L     | $De = 38.25 + 0.04025 * \Sigma T$  | 95.70        | 3.678 |
|                    | Q     | $De = 32.07 + 0.07291 * \Sigma T - 0.000025 * \Sigma T^2$                      | 99.97        | 0.310 |
|                    | K     | $De = 31.89 + 0.07511 * \Sigma T - 0.000030 * \Sigma T^2 + 0.000 * \Sigma T^3$ | 99.97        | 0.320 |
| 33.58<br>(33 – 35) | L     | $De = 40.10 + 0.04232 * \Sigma T$  | 96.03        | 3.712 |
|                    | Q     | $De = 33.88 + 0.07524 * \Sigma T - 0.000025 * \Sigma T^2$                      | 99.96        | 0.364 |
|                    | K     | $De = 33.74 + 0.07684 * \Sigma T - 0.000029 * \Sigma T^2 + 0.000 * \Sigma T^3$ | 99.96        | 0.367 |

Nga krahasimi i të dhënave të Tabelës 3.5. rezulton se për të pese intervalet e diametrave ekuatorialë të kultivarit Golden Delicious, modeli kuadratik i regresionit ka qene me i përshtatshmi në përshkrimin e marrëdhënies ndërmjet rritjes së këtyre diametrave dhe shumës së temperaturave ditore të rritjes nga 40 – 152 DPLP. Me një nivel besueshmërie prej 95%, Koeficienti i Përcaktueshmërisë ( $R^2$ ) i këtij modeli për të pese intervalet e diametrave ishte me i larti, ndërsa Deviacioni Standard me i ulëti. Shume afër këtij modeli qëndron ai kubik, ndërsa modeli linear rezultoi me pak i përshtatshëm për tu përdorur në raport me dy të tjerët.

Edhe në krahasimin e të dhënave të Tabelës 3.6, për të pese interval diametrat gjatësore të kultivarit Golden Delicious, rezulton se modeli kuadratik ka qene

më i përshtatshmi në përshkrimin e marrëdhënies ndërmjet rritjes së këtyre diametrave dhe shumës së temperaturave ditore të rritjes nga 40 – 152 DPLP, sepse edhe për këtë grup diametrash Koeficienti i Përcaktueshmërisë ( $R^2$ ) i këtij modeli ishte me i larti ndërsa Deviacioni Standard me i ulëti.

Në pikëpamjen praktike, përshtatshmëria me e madhe e modelit kuadratik do të thotë se rritja e diametrave ekuatorialë dhe gjatësorë ka ndjekur modelin e nje vije të lakuar, pa ulje-ngritje të ndjeshme, të cilat nëse ndodhnin, do ti jepnin nga ana statistikore përshtatshmëri me të madhe modelit kubik.

Kjo nënkupton që shërbimet agroteknike dhe veçanërisht ujitjet gjate periudhës se rritjes së frutave kane qene të mjaftueshme për të mos shkaktuar diferenca të ndjeshme në ritmiken e rritjes së frutave.

**Tabela 3.6 Krahasimi i tre modeleve të ekuacioneve për diametrat gjatësorë**  
( $p < 0.05$ )

| Dgj (mm)<br>40 DPLP | Model | Ekuacionet i regresionit për grup diametrat gjatësorë                              | R <sup>2</sup><br>(%) | DS    |
|---------------------|-------|--|-----------------------|-------|
| 30.37<br>(27 – 31)  | L     | $D_{gj} = 34.66 + 0.02401 * \Sigma T$  | 94.61                 | 2.573 |
|                     | Q     | $D_{gj} = 30.46 + 0.04554 * \Sigma T - 0.000016 * \Sigma T^2$                      | 99.94                 | 0.276 |
|                     | K     | $D_{gj} = 30.55 + 0.04444 * \Sigma T - 0.000014 * \Sigma T^2 - 0.000 * \Sigma T^3$ | 99.94                 | 0.280 |
| 31.71<br>(30 – 33)  | L     | $D_{gj} = 35.99 + 0.02760 * \Sigma T$  | 96.21                 | 2.462 |
|                     | Q     | $D_{gj} = 31.97 + 0.04823 * \Sigma T - 0.000015 * \Sigma T^2$                      | 99.97                 | 0.233 |
|                     | K     | $D_{gj} = 31.98 + 0.04809 * \Sigma T - 0.000015 * \Sigma T^2 - 0.000 * \Sigma T^3$ | 99.96                 | 0.242 |
| 33.72<br>(32 – 36)  | L     | $D_{gj} = 38.29 + 0.03068 * \Sigma T$  | 95.93                 | 2.796 |
|                     | Q     | $D_{gj} = 33.72 + 0.05488 * \Sigma T - 0.000019 * \Sigma T^2$                      | 99.97                 | 0.223 |
|                     | K     | $D_{gj} = 33.67 + 0.05542 * \Sigma T - 0.000020 * \Sigma T^2 + 0.000 * \Sigma T^3$ | 99.97                 | 0.230 |
| 37.25<br>(33 – 37)  | L     | $D_{gj} = 42.81 + 0.03363 * \Sigma T$  | 94.85                 | 3.378 |
|                     | Q     | $D_{gj} = 37.16 + 0.06105 * \Sigma T - 0.000023 * \Sigma T^2$                      | 99.94                 | 0.364 |
|                     | K     | $D_{gj} = 37.25 + 0.06245 * \Sigma T - 0.000021 * \Sigma T^2 - 0.000 * \Sigma T^3$ | 99.94                 | 0.372 |
| 37.05<br>(35 – 38)  | L     | $D_{gj} = 42.26 + 0.03533 * \Sigma T$  | 95.83                 | 3.178 |
|                     | Q     | $D_{gj} = 36.97 + 0.06332 * \Sigma T - 0.000022 * \Sigma T^2$                      | 99.92                 | 0.493 |
|                     | K     | $D_{gj} = 37.34 + 0.05906 * \Sigma T - 0.000013 * \Sigma T^2 - 0.000 * \Sigma T^3$ | 99.90                 | 0.551 |

### **3.1.2. PËRPILIMI I TABELËS PARASHIKUESE PËR RITJEN E DIAMETRIT EKUATORIAL DHE GJATËSOR TË KULTIVARIT GOLDEN DELICIOUS NË LIDHJE ME SHUMAT FIKSE TË TEMPERATURAVE DITORE TË RITJES NË TË DY VITET**

Për të realizuar këtë përpilim u përdorën ekuacionet kuadratike të regresionit për secilin diametër mesatar të Tabelës 3.5 dhe 3.6. Vlerat fikse të  $\Sigma T=100^{\circ}C$ ,

$\Sigma T=150^{\circ}\text{C}$ ,  $\Sigma T=200^{\circ}\text{C}$ ...  $\Sigma T=1350^{\circ}\text{C}$  të shumave të ditore të temperaturave ditore të rritjes shërbyen si variabla të pavarura në këto ekuacione (Tabela 3.7). Në një vërtetim pesë vjeçar (2009 – 2013) në lidhje me shumën e temperaturave ditore të rritjes ( $\Sigma T$ ) të grumbulluara nga 40 DPLP deri në 152 DPLP rezultoi se mesatarja e tyre për këto vite ishte  $1275^{\circ}\text{C}$ .

Në vitin 2012 me temperatura më të larta nga të tjerët, gjatë periudhës të sipërpërmendur 40 – 152 DPLP u grumbulluan  $1334^{\circ}\text{C}$ , ndërsa në vitin 2013 për të njëjtën periudhë u grumbulluan  $1267^{\circ}\text{C}$ , vlerë e cila është shumë afër mesatares së këtyre pesë viteve.

Në vite me temperatura normale gjatë sezonit të rritjes së frutave nga 40 DPLP deri në vjelje, dhe në kushtet e zbatimit të shërbimeve agroteknike të njëjta çdo vit, përfshirë këtu dhe ngarkesën e njëjtë me fruta për çdo  $\text{cm}^2$  të sipërfaqes të prerjes tërthore të trungut, ecuria e rritjes e frutave do të jete shumë e ngjashme nga njëri vit në tjetrin. Në kushte të tilla, madhësia e diametrit të frutave të mollës në 40 DPLP do të ishte vendimtar në madhësinë përfundimtare të tyre (Berg 1990; Warrington et al., 1999)

Nga ana tjetër, shembujt e literaturës kanë treguar se kur temperaturat ditore të rritjes kanë qene mjaft me të larta se mesatarja shumëvjeçare, rritja e frutave ka rënë përkundjet ritmit normal, sepse mollët kalojnë në gjendje stresi nga temperatura (Berg dhe Lotze, 2006).

**Tabela 3.7. Rritja e grup diametrave sipas shumave fikse të temperaturave të rritjes**

| $\Sigma T$<br>( $^{\circ}\text{C}$ ) | Grupet e frutave në lidhje me $\Sigma T$ |       |         |       |         |       |         |       |         |       |
|--------------------------------------|--|-------|---------|-------|---------|-------|---------|-------|---------|-------|
|                                      | Grupi 1                                  |       | Grupi 2 |       | Grupi 3 |       | Grupi 4 |       | Grupi 5 |       |
|                                      | De                                       | Dgj   | De      | Dgj   | De      | Dgj   | De      | Dgj   | De      | Dgj   |
| 0.0                                  | 26.76                                    | 30.37 | 28.07   | 31.71 | 30.02   | 33.72 | 32.07   | 37.25 | 33.58   | 37.05 |
| 100.0                                | 32.26                                    | 34.85 | 34.21   | 36.64 | 36.77   | 39.02 | 39.11   | 43.04 | 41.15   | 43.08 |
| 150.0                                | 34.86                                    | 36.93 | 37.01   | 38.87 | 39.89   | 41.52 | 42.44   | 45.80 | 44.60   | 45.97 |
| 200.0                                | 37.36                                    | 38.93 | 39.70   | 41.02 | 42.89   | 43.94 | 45.65   | 48.45 | 47.93   | 48.75 |
| 250.0                                | 39.76                                    | 40.85 | 42.30   | 43.09 | 45.77   | 46.25 | 48.74   | 50.99 | 51.13   | 51.43 |
| 300.0                                | 42.07                                    | 42.68 | 44.80   | 45.09 | 48.54   | 48.47 | 51.69   | 53.41 | 54.20   | 53.99 |
| 350.0                                | 44.28                                    | 44.44 | 47.20   | 47.01 | 51.19   | 50.60 | 54.53   | 55.71 | 57.15   | 56.44 |
| 400.0                                | 46.40                                    | 46.12 | 49.50   | 48.86 | 53.73   | 52.63 | 57.23   | 57.90 | 59.98   | 58.78 |
| 450.0                                | 48.43                                    | 47.71 | 51.70   | 50.64 | 56.16   | 54.57 | 59.82   | 59.98 | 62.68   | 61.01 |
| 500.0                                | 50.36                                    | 49.23 | 53.80   | 52.34 | 58.47   | 56.41 | 62.28   | 61.94 | 65.25   | 63.13 |


|        |       |       |       |       |       |       |       |       |       |       |
|--------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|
| 550.0  | 52.19 | 50.67 | 55.79 | 53.96 | 60.66 | 58.16 | 64.61 | 63.78 | 67.70 | 65.14 |
| 600.0  | 53.93 | 52.02 | 57.69 | 55.51 | 62.74 | 59.81 | 66.82 | 65.51 | 70.02 | 67.04 |
| 650.0  | 55.57 | 53.30 | 59.49 | 56.98 | 64.70 | 61.36 | 68.90 | 67.13 | 72.22 | 68.83 |
| 700.0  | 57.12 | 54.50 | 61.19 | 58.38 | 66.55 | 62.83 | 70.86 | 68.63 | 74.30 | 70.51 |
| 750.0  | 58.58 | 55.62 | 62.79 | 59.71 | 68.29 | 64.19 | 72.69 | 70.01 | 76.25 | 72.09 |
| 800.0  | 59.93 | 56.65 | 64.29 | 60.95 | 69.90 | 65.46 | 74.40 | 71.28 | 78.07 | 73.55 |
| 850.0  | 61.20 | 57.61 | 65.68 | 62.13 | 71.41 | 66.64 | 75.98 | 72.44 | 79.77 | 74.90 |
| 900.0  | 62.37 | 58.49 | 66.98 | 63.23 | 72.80 | 67.72 | 77.44 | 73.48 | 81.35 | 76.14 |
| 950.0  | 63.44 | 59.28 | 68.18 | 64.25 | 74.07 | 68.71 | 78.77 | 74.40 | 82.80 | 77.27 |
| 1000.0 | 64.42 | 60.00 | 69.28 | 65.20 | 75.23 | 69.60 | 79.98 | 75.21 | 84.12 | 78.29 |
| 1050.0 | 65.30 | 60.64 | 70.28 | 66.07 | 76.27 | 70.40 | 81.06 | 75.91 | 85.32 | 79.20 |
| 1100.0 | 66.09 | 61.19 | 71.18 | 66.87 | 77.20 | 71.10 | 82.02 | 76.49 | 86.39 | 80.00 |
| 1150.0 | 66.79 | 61.67 | 71.98 | 67.60 | 78.02 | 71.70 | 82.85 | 76.95 | 87.34 | 80.69 |
| 1200.0 | 67.39 | 62.07 | 72.67 | 68.25 | 78.72 | 72.22 | 83.56 | 77.30 | 88.17 | 81.27 |
| 1250.0 | 67.89 | 62.39 | 73.27 | 68.82 | 79.30 | 72.63 | 84.15 | 77.54 | 88.87 | 81.75 |
| 1300.0 | 68.30 | 62.62 | 73.77 | 69.32 | 79.77 | 72.95 | 84.60 | 77.66 | 89.44 | 82.11 |
| 1350.0 | 68.61 | 62.78 | 74.17 | 69.74 | 80.12 | 73.18 | 84.94 | 77.66 | 89.89 | 82.36 |

Vlerat e diametrave në Tabelën 3.7 tregojnë se deri në vjelje, grupet e frutave të mollës Golden Delicious me diametra me të vegjël në 40 DPLP rriten me pak se ata me diametra me të mëdhenj në po atë date. Diferenca ndërmjet çdo grupi të diametrit ekuatorial në 40 DPLP ishte 1.31 – 2.05 mm, ndërsa në vjelje ajo u zgjerua në 4.82 – 5.95 mm (Grafiku 3.2.).

Në të njëjtën mënyre, diferenca ndërmjet grup diametrave gjatësorë, për periudhën si me sipër, zgjerohet nga 0.20 - 3.53 mm në 40 DPLP në 3.24 – 6.96 mm në vjelje.

Konkluzioni është se frutat e mëdhenj kane ritëm me të larte rritje se frutat e vegjël. Kjo është në përputhje me përfundimet e nxjerra nga Lakso dhe Goffinet (2013) sipas të cileve brenda një peme me molle, frutat që janë me diametër të vogël në 40 DPLP nuk mund të arrijnë kurrë gjatë rritjes së tyre frutat që kane diametër me të madh në po atë date. Në numërimin e qelizave për frut, ata gjeten se diferenca në ritmin e rritjes ishte e lidhur drejtpërdrejt me numrin e qelizave në frut, sepse secila prej tyre rritej me të njëjtin ritëm ditor. Meqenëse numri i qelizave në një frut përcaktohet brenda periudhës 40 ditore pas lulëzimit të plote, kjo periudhe cilësohet si shumë e rëndësishme në të gjithë sezonin për madhësinë

përfundimtare të frutave të mollës në vjelje (Lakso dhe Goffinet, 2013).



**Grafiku 3.1. Rritja diferencës mes grup-diametrave ekuatoriale të kultivari Golden Delicious**

### **3.1.3. PËRLLOGARITJA E EKUACIONEVE TË REGRESIONIT QË SHPREHIN MARRËDHËNIEN NDËRMJET PESHËS SË FRUTAVE TË GOLDEN DELICIOUS NË FUNKSION TË DIAMETRAVE EKUATORIALE DHE GJATËSORE TË TYRE.**

Në të dy vitet e studimit 2012 dhe 2013, të gjithë frutat e etiketuar të kultivari Golden Delicious, pasi ju maten diametrat ekuatoriale dhe gjatësorë të tyre u volën në 152 dite pas lulëzimit të plote, në datën 3 Tetor 2012 dhe 26 Shtator 2013. Secili prej tyre u peshua veçmas në peshoren elektronike. Të dhënat përkatëse të peshës u hodhën në regjistrin elektronik në kolonën ngjitur me atë të diametrave përfundimtarë. Nga numri fillestar prej 200 frutash të etiketuar në 40 DPLP, në vitin 2012 kishin mbetur në vjelje 189 fruta, ndërsa në vitin 2013 ishin 186 fruta. Të tjerët kishin rënë për shkaqe të ndryshme.

Për të përpiluar tabelën parashikuese të peshës së frutave në lidhje me diametrat e tyre përkatës në momentin e vjeljes (152 DPLP), për secilin nga të pëste grup diametrat u përdor ekuacioni i shumëfishtë i regresionit, në formën:

$$\text{Pesha} = b_0 + b_1De + b_2Dgj$$

Ky ekuacion që shprehte marrëdhënien ndërmjet diametrave të frutave dhe peshës së tyre rezultoi tepër i sakte për cdo grup diametrash, me një gabim

absolut prej me pak se 0.5 g/frut (Tabela 3.8). Në të pese ekuacionet, vlera e Koeficientit të Përcaktueshmërisë ( $R^2$ ) ishte shume i larte, në diapazonin 0.961 – 0.999, ndërsa deviacioni standard (DS) 0.284 – 0.397. Me të tilla nivele të larte saktësie, ekuacionet e secilit grup mund të përdoren për të parashikuar peshën përfundimtare të çdo fruti molle brenda grupit përkatës të diametrave. Krahasimi i peshës mesatare të frutave në momentin e vjeljes tregoi nje diference të madhe mes grupeve, pasi frutat e grupit të peste (me diametra me të mëdhenj) kishin nje peshe 1.8 here me të madhe (267.8g / 148.8g) se ata të grupit të pare (me diametrat me të vegjël). Ky përfundim eshte në të njëjtën drejtim me atë që kane nxjerre në pah dhe Lakso dhe Goffinet (2013) në lidhje me rolin që ka madhësia e diametrit në 40 DPLP në peshën përfundimtare të frutit.

**Tabela 3.8. Pesha e frutit e Golden Delicious për secilin grup diametrash në 152 DPLP**

( $p < 0.05$ )

| Grupet e frutave | De & Dgj (mm) 152 DPLP |       | Ekuacionet e regresionit të peshës për grupet e diametrave 152 DAFB | $R^2$ | DS    | Pesha (g) e frutit 152 DPLP |
|------------------|------------------------|-------|---|-------|-------|-----------------------------|
|                  | De                     | Dgj   |   |       |       |                             |
| 1                | 68.58                  | 62.93 | $M = -256 + 4.15*De + 1.91*Dgj$                                     | 0.961 | 0.397 | 148.8 ±0.2                  |
| 2                | 74.08                  | 68.93 | $M = -253 + 4.04*De + 1.97*Dgj$                                     | 0.999 | 0.284 | 182.1 ±0.3                  |
| 3                | 79.27                  | 73.31 | $M = -251 + 3.99*De + 2.00*Dgj$                                     | 0.998 | 0.304 | 211.9 ±0.3                  |
| 4                | 84.36                  | 80.58 | $M = -246 + 3.93*De + 2.00*Dgj$                                     | 0.998 | 0.372 | 246.7 ±0.4                  |
| 5                | 88.75                  | 82.19 | $M = -244 + 3.97*De + 1.94*Dgj$                                     | 0.998 | 0.334 | 267.8 ±0.3                  |

| 30 Shtator (150 DPLP)         | 20                     | 6.9                                     | 13.1  | 7.2                         | 0.073          |
| 2 Tetor (152 DPLP)            | 20                     | 6.8                                     | 13.3  | 7.6                         | 0.067          |

Nga të dhënat e Tabeles 3.33. rezulton se për kultivarin Red Chief vlerat e Indeksit Streif për vitin 2012 kane filluar nga 0.255 në 130 DPLP deri në 0.067 në 152 DPLP. Rezultatet e studimeve të kryera në vendet e tjera rekomandojnë se për frutat e këtij kultivari të destinuara për magazinimin frigoriferik afatgjate, afati optimal i vjeljes së tyre është kur vlera e Indeksit Streif = 0.12, ndërsa dritarja e vjeljes 0.11 – 0.13 (A. Kader, komunikim personal, 19 Shtator 2012). Vlera 0.12 e këtij Indeksi për vitin 2012 u arrit në datën 20 Shtator, që korrespondonte me 140 DPLP, ndërsa dritarja e vjeljes ishte tre ditore, nga 19 – 22 Shtator, ose 139 – 142 DPLP. Vjeljet e frutave të këtij kultivari në datat e mëvonshme duhet të destinoheshin për magazinim afatshkurtër ose konsum të menjëhershëm.

**Tabela 3.34. Treguesit e pjekjes dhe Indeksi Streif i Red Chief (viti 2013)**

| Datat e mostrimit<br>(viti 2013) | Madhësi<br>mostre<br>(fruta) | Fortësia<br>Mesatare<br>(kg/cm <sup>2</sup> ) | Totali<br>lendeve<br>tretshme<br>( <sup>0</sup> Briks) | Treguesi i<br>amidnit<br>(1 -10) | Indeksi<br>Streif |
|----------------------------------|------------------------------|---|--|----------------------------------|-------------------|
| 03 Shtator (130 DPLP)            | 20                           | 8.0   | 10.4   | 3.0                              | 0.256             |
| 08 Shtator (135 DPLP)            | 20                           | 7.8   | 11.0   | 4.1                              | 0.173             |
| 13 Shtator (140 DPLP)            | 20                           | 7.5   | 11.5   | 5.2                              | 0.125             |
| 18 Shtator (145 DPLP)            | 20                           | 7.3   | 12.1   | 6.0                              | 0.101             |
| 23 Shtator (150 DPLP)            | 20                           | 7.1   | 12.8   | 6.7                              | 0.083             |
| 25 Shtator (152 DPLP)            | 20                           | 7.0   | 13.0   | 7.2                              | 0.075             |

Sipas të dhënave të përlllogaritjeve që jepen në Tabelën 3.34, vlerat e Indeksit Streif për vitin 2013 kane ardhur duke zbritur në çdo date pasardhëse nga 0.256 në 130 DPLP në 0.075 në 152 DPLP. Në Grafikun 3.6 paraqiten kurbat rënëse të Indeksit Streif në lidhje me ditët pas lulëzimit të plote për të dy vitet e studimit. Ndonëse kurbat kane fillim thujse të njëjtë në 130 DPLP, në vijimësi nga data në date ajo e vitit 2012 është me e pjerrët, sepse në 152 DPLP vlera e saj arriti 0.067 kundrejt 0.075 në vitin 2013. Data optimale e vjeljes për vitin 2013 ishte 14 Shtatori (141 DPLP) ndërsa dritarja e vjeljes ishte katër ditore nga 12 – 16 Shtator (139 – 143 DPLP). Ashtu si në vitin 2012, vjeljet e frutave në data më të vonshme se 16 Shtatori duhet të destinoheshin për magazinim afatshkurtër ose konsum të menjëhershëm.



**Grafiku 3.4. Indeksi Streif i kultivarit Red Chief në vitin 2012 dhe 2013**

### 3.3. KULTIVARI GRANNY SMITH

Për kultivarin Granny Smith, datat e lulëzimit të plote ishin 5 Maj 2012 dhe 28 Prill 2013, ndersa matja e pare e diametrit ekuatorial dhe gjatësor të 200 frutave të etiketuara u krye 40 dite pas lulëzimit të plote (DPLP), në datat 14 Qershor 2012 dhe 7 Qershor 2013 (Tabela 3.1 dhe Tabela 3.2).

**Tabela 3.35. Frutat e Granny Smith sipas diametrave ekuatoriale në 40 DPLP**

| Viti | 27–29 mm  |                  | 29-31 mm    |                  | 31-33 mm  |           | 33–35 mm         |             |
|------|-----------|------------------|-------------|------------------|-----------|-----------|------------------|-------------|
|      | Nr. fruta | D <sub>mes</sub> | Nr. i fruta | D <sub>mes</sub> | Nr. fruta | Nr. fruta | D <sub>mes</sub> | Nr. i fruta |
| 2012 | 88        | 28.37            | 92          | 29.89            | 20        | 31.28     | -                | -           |
| 2013 | -         | -                | -           | -                | 132       | 32.20     | 68               | 33.77       |

Nga të dhënat e Tabelës 3.35 rezulton se dyqind frutat e etiketuara të vitit 2012 kishin diametra ekuatoriale në tre intervale madhësish: 27 – 29 mm, 29 – 31 mm dhe 31 – 33 mm, ndërsa ato të vitit 2013 në dy intervale: 31 – 33 mm dhe 33 – 35 mm.

**Tabela 3.36. Frutat e Granny Smith sipas diametrave gjatësorë në 40 DPLP**

| Viti | 27 – 30 mm |                  | 30 – 32 mm |                  | 31 – 34 mm |                  | 33 – 36 mm |                  |
|------|------------|------------------|------------|------------------|------------|------------------|------------|------------------|
|      | Nr. fruta  | D <sub>mes</sub> | Nr. fruta  | D <sub>mes</sub> | Nr. fruta  | D <sub>mes</sub> | Nr. fruta  | D <sub>mes</sub> |
| 2012 | 88         | 28.80            | 92         | 30.23            | 20         | 31.92            | -          | -                |
| 2013 | -          | -                | -          | -                | 132        | 32.82            | 68         | 34.45            |



Të dhënat e Tabelës 3.36 tregojnë se edhe diametrat korrespondues gjatësorë në këto dy vite ishin të ndryshëm, ato të vitit 2012 i përkisnin tre grup intervaleve 27- 30 mm, 30 – 32 mm dhe 31 – 34 mm, ndërsa diametrat e vitit 2013 dy intervaleve: 31 – 34 mm dhe 33 – 36 mm.

Në krahasimin mes tyre të vlerave mesatare të diametrave ekuatoriale dhe gjatësorë të dy viteve në këtë matje të pare, rezultoi se edhe për kultivarin Granny Smith, sikurse për Golden Delicious dhe Red Chief, në këtë studim, diametrat e vitit 2013 ishin me të mëdhenj se ata të vitit 2012 mesatarisht 3.38 mm ekuatorialet dhe 3.60 mm gjatësorët, ndonëse ngarkesa me lule, ngarkesa me fruta pas rrallimit, sikundër dhe shërbimet agroteknike ishin të njëjta në të dy vitet. Ashtu sic u evidentua dhe në rastin e dy kultivarëve të tjerë, edhe për Granny Smith nje faktor ndikues i rëndësishëm që mund të shpjegoje këtë diference në madhësi diametrash është shuma e temperaturave ditore të rritjes të grumbulluara nga dita e lulëzimit të plote deri në 40 DPLP në secilin vit. Në vitin 2012 gjate kësaj periudhe u grumbulluan 160°C, ndërsa në vitin 2013 ato ishin 265°C, ose 105°C me tepër. Edhe në rastin e këtij kultivari, temperaturat në vitin 2013 kane qene me të favorshme për rritjen fillestare të frutave, dhe roli i tyre në periudhën nga lulëzimi i plote deri në 40 DPLP është argumentuar në studimet e Bergh (1990) dhe Warrington et al, (1999).

Pas matjes së pare në 40 DAFB, matjet e tjera të diametrave vazhduan me intervale kohore prej shtate ditësh nga njëra tjetra duke u realizuar deri në vjelje (159 DPLP) gjithsej 18 matje. Gjate gjithë periudhës nga data e lulëzimit të plote deri në vjelje, u regjistruan të dhënat e temperaturave ditore të rritjes si dhe shuma e këtyre temperaturave ( $\Sigma T$ ) për çdo shtate ditë dhe progresivi deri në vjelje, duke marre të dhënat nga stacioni meteorologjik i QTTB. Megjithëse temperaturat ditore të rritjes nga dita e lulëzimit të plote deri në 40 DPLP u regjistruan për efekte studimore, në përlllogaritjen e ekuacioneve të regresionit, atyre ju dha vlera fillestare prej 0.0°C në matjen e pare të frutave (40 DPLP) dhe që nga ajo dite ato u kumuluan në vazhdimësi deri në vjelje (Tabela 3.37).

**Tabela 3.37. DPLP në datat korresponduese të tyre dhe  $\Sigma T$  për Granny Smith**

| Viti 2012 |            |            | Viti 2013 |            |            |
|-----------|------------|------------|-----------|------------|------------|
| DPLP      | Data       | $\Sigma T$ | DPLP      | Data       | $\Sigma T$ |
| 40        | 14 Qershor | 0.00       | 40        | 7 Qershor  | 0.00       |
| 47        | 21 Qershor | 65.8       | 47        | 14 Qershor | 60.6       |
| 54        | 28 Qershor | 147.9      | 54        | 21 Qershor | 147.4      |
| 61        | 5 Korrik   | 235.7      | 61        | 28 Qershor | 225.8      |
| 68        | 12 Korrik  | 346.9      | 68        | 5 Korrik   | 291.4      |
| 75        | 19 Korrik  | 450.5      | 75        | 12 Korrik  | 369.4      |

|     |            |        |     |            |        |
|-----|------------|--------|-----|------------|--------|
| 82  | 26 Korrik  | 556.1  | 82  | 19 Korrik  | 452.9  |
| 89  | 2 Gusht    | 657.8  | 89  | 26 Korrik  | 537.1  |
| 96  | 9 Gusht    | 769.2  | 96  | 2 Gusht    | 654.1  |
| 103 | 16 Gusht   | 843.2  | 103 | 9 Gusht    | 766.0  |
| 110 | 23 Gusht   | 938.6  | 110 | 16 Gusht   | 860.90 |
| 117 | 30 Gusht   | 1038.8 | 117 | 23 Gusht   | 953.8  |
| 124 | 6 Shtator  | 1118.6 | 124 | 30 Gusht   | 1024.6 |
| 131 | 13 Shtator | 1178.3 | 131 | 6 Shtator  | 1089.8 |
| 138 | 20 Shtator | 1220.1 | 138 | 13 Shtator | 1157.6 |
| 145 | 27 Shtator | 1268.9 | 145 | 20 Shtator | 1213.6 |
| 152 | 4 Tetor    | 1334.0 | 152 | 27 Shtator | 1246.0 |
| 159 | 11 Tetor   | 1368.4 | 159 | 4 Tetor    | 1279.5 |

Në të dy vitet, në përfundim të 18 matjeve, diametrat ekuatoriale u radhiten në regjistrin elektronik njeri pas tjetrit në drejtimin e tyre rritës (nga diametri më i vogël tek më i madhi) bazuar në vlerat e tyre në 40 DPLP. Në këtë radhitje, secili diametër ekuatorial shoqërohet gjithmonë në kolonën ngjitur nga diametri gjatësor përkatës.

Për të mundësuar përlllogaritje dhe parashikime me të sakta të dinamikës të rritjes të frutave, tërësia e vlerave të diametrave ekuatoriale u nda në grupe me intervale madhësisht 2 mm nga njeri tjetri, në pese grupe gjithsej. Edhe diametrat gjatësorë korrespondues të tyre u radhiten në intervalet përkatëse.

Në tabelën 3.38 jepet tërësia e diametrave ekuatorialë dhe gjatësorë të grupuar në intervalet korrespondues për secilin vit të studimit, duke filluar nga 40 DPLP deri në vjelje, 159 DPLP, për të 18 matjet e kryera.

Të dhënat e Tabelës 3.38 tregojnë se dinamika e rritjes së diametrave në vlerë absolute ka qenë më e madhe nga njëra matje tek tjetra gjatë periudhës së parë të rritjes së tyre, ndërsa duke filluar nga mesi i sezonit e në vazhdim ajo ka ardhur duke u ulur deri në vjelje. Ashtu sic u përmend për kultivarët Golden Delicious dhe Red Chief, edhe tek Granny Smith, kjo ulje nuk mund të çonte në reduktim të rritjes në peshe të frutave, sepse sipas Lakso dhe Goffinet (2013), nga mesi i sezonit deri në vjelje, rritja e përmasave të frutit qofte dhe me 1 mm përfaqëson në realitet disa gram shtese, ndërsa e njëjta rritje prej 1 mm në fazat e hershme me pak se një gram.

Bazuar në të dhënat përmbledhëse të Tabelës 3.38 dhe ato më të detajuara të regjistrimit elektronik të kultivarit Granny Smith, rezulton se për vitin 2012, të gjitha frutat e etiketuara dhe të mbetura në pemë deri në momentin e vjeljes kishin diametrin e tyre ekuatorial më të madh se 60 mm, që konsiderohet si kufiri i poshtëm i standardit të mollëve për çdo kultivar (UNECE, 2010).

**Tabela 3.38. Diametrat ekuatoriale e gjatësorë të Granny Smith nga 40 – 159 DPLP**

| DPLP | Diametrat mesatare në mm<br>(2012) |                  |                 |                  | Diametrat mesatare në mm<br>(2013) |                  |                 |                  |                 |                  |
|------|------------------------------------|------------------|-----------------|------------------|------------------------------------|------------------|-----------------|------------------|-----------------|------------------|
|      | De <sub>1</sub>                    | Dgj <sub>1</sub> | De <sub>2</sub> | Dgj <sub>2</sub> | De <sub>3</sub>                    | Dgj <sub>3</sub> | De <sub>4</sub> | Dgj <sub>4</sub> | De <sub>5</sub> | Dgj <sub>5</sub> |
| 40   | 28.37                              | 28.80            | 29.89           | 30.23            | 31.28                              | 31.92            | 32.20           | 32.82            | 33.77           | 34.45            |
| 47   | 32.24                              | 31.02            | 33.77           | 32.64            | 35.54                              | 34.46            | 36.68           | 35.55            | 38.47           | 37.15            |
| 54   | 35.49                              | 34.09            | 37.39           | 35.72            | 39.12                              | 37.61            | 41.96           | 39.37            | 44.01           | 41.33            |
| 61   | 40.19                              | 37.80            | 42.34           | 39.67            | 44.30                              | 41.89            | 47.88           | 44.39            | 50.22           | 46.38            |
| 68   | 44.82                              | 41.79            | 47.22           | 44.17            | 49.41                              | 46.32            | 50.82           | 46.54            | 53.30           | 48.85            |
| 75   | 49.36                              | 46.74            | 52.00           | 49.06            | 54.40                              | 51.80            | 55.46           | 50.51            | 58.17           | 53.02            |
| 82   | 54.28                              | 49.51            | 57.18           | 51.96            | 59.82                              | 54.87            | 60.13           | 54.85            | 63.06           | 57.57            |
| 89   | 58.31                              | 53.22            | 61.43           | 55.87            | 64.26                              | 58.99            | 64.19           | 58.35            | 67.14           | 61.25            |
| 96   | 62.04                              | 56.83            | 65.36           | 59.86            | 68.37                              | 62.99            | 68.26           | 62.54            | 71.59           | 65.65            |
| 103  | 64.80                              | 59.26            | 68.27           | 62.31            | 71.40                              | 65.79            | 72.94           | 67.01            | 76.49           | 70.34            |
| 110  | 67.21                              | 61.36            | 70.81           | 64.41            | 74.06                              | 68.01            | 75.53           | 69.40            | 79.21           | 72.84            |
| 117  | 70.12                              | 63.95            | 73.87           | 67.13            | 77.26                              | 70.88            | 78.87           | 72.40            | 82.71           | 75.99            |
| 124  | 72.58                              | 66.42            | 76.46           | 69.72            | 79.96                              | 73.62            | 81.12           | 74.57            | 85.08           | 78.27            |
| 131  | 74.66                              | 68.14            | 78.65           | 71.33            | 82.24                              | 75.74            | 83.44           | 76.62            | 87.50           | 80.42            |
| 138  | 76.10                              | 69.15            | 80.17           | 72.48            | 83.83                              | 76.64            | 85.05           | 77.68            | 89.19           | 81.53            |
| 145  | 77.05                              | 69.91            | 81.17           | 73.38            | 84.87                              | 77.48            | 86.10           | 78.51            | 90.30           | 82.41            |
| 152  | 77.88                              | 70.59            | 82.04           | 74.09            | 85.77                              | 78.14            | 87.28           | 79.44            | 91.53           | 83.38            |
| 159  | 78.40                              | 71.13            | 82.59           | 74.76            | 86.34                              | 78.73            | 87.58           | 79.58            | 91.85           | 83.53            |

Frutat e grupit të pare me diametër mesatar ekuatorial 28.37 mm në 40 DPLP, kur u volën në 152 DPLP arritën diametrin 78.40 mm (brenda grupit fruti me i vogël ishte 75.68 mm, me i madhi 80.10 mm). Edhe në vitin 2013, frutat e etiketuar të dy grupeve rezultuan në vjelje të gjithë me diametra me të mëdhenj se 80 mm, me i vogli në grupin para kishte diametrin 84.39 mm, ndërsa me i madhi i grupit të dyte 94.56 mm.


### **3.3.1. PËRCAKTIMI I EKUACIONIT ME TË PËRSHTATSHËM TË REGRESIONIT QË SHPREH MARRËDHËNIEN NDËRMJET RITJES SË DIAMETRIT DHE SHUMES TË TEMPERATURAVE DITORE TË RITJES TË KULTIVARIT GRANNY SMITH.**

Për të përcaktuar ekuacionin me të përshtatshëm të regresionit që shpreh marrëdhënien ndërmjet rritjes së diametrave ekuatoriale dhe gjatësorë dhe shumes të temperaturave ditore të rritjes për kultivarin Granny Smith nga 40 DPLP deri 159 DPLP, vlerat e secilit diametër ekuatorial dhe gjatësor në Tabelën 3.38 u futen në formën e kolonave përkatëse në fletën e punës të programit

statistikor Minitab 16.1. Sipas metodikes, u krahasuan mes tyre të tre modelet e ekuacioneve të regresionit:

- Modeli Linear (L);
- Modeli kuadratik (Q);
- Modeli kubik (K).

Ekuacioni me i përshtatshëm do të ishte ai që kishte vlerën me të larte të Koeficientit të Përcaktueshmërisë ( $R^2$ ) dhe vlerën me të ulet të Deviacionit Standard (DS). Përzgjedhja e ekuacionit me të përshtatshëm të regresionit nga programi statistikor Minitab 16.1. për diametrin ekuatorial të Granny Smith:  $De = 28.23$  mm tregohet në Grafikun 3.7.



**Foto 3.4. Përzgjedhja e modelit të ekuacionit e Granny Smith De 28.37 mm**

Nga krahasimi i të dhënave të Tabelës 3.39 rezulton se për të pese interval diametrat ekuatorialë të kultivarit Granny Smith, modeli kuadratik i ekuacionit të regresionit ka qene me i përshtatshmi në përshkrimin e marrëdhënies ndërmjet rritjes së këtyre diametrave dhe shumes së temperaturave ditore të rritjes nga 40 – 159 DPLP. Me nje nivel besueshmërie prej 95%, Koeficienti i Përcaktueshmërisë ( $R^2$ ) i këtij modeli për të pese intervalet e diametrave ishte me i larti, ndërsa Deviacioni Standard me i ulëti. Shume afër këtij modeli qëndron ai kubik, ndërsa modeli linear rezultoi me pak i përshtatshëm për tu përdorur në raport me dy të tjerët.

**Tabela 3.39. Krahasimi i tre modeleve të ekuacioneve për diametrat ekuatoriale**  
( $p < 0.05$ )

| De (mm)<br>40 DPLP | Model | Ekuacionet e regresionit për grup diametrat ekuatoriale                        | R <sup>2</sup><br>(%) | DS    |
|--------------------|-------|--|-----------------------|-------|
| 28.37<br>(27 – 29) | L     | $De = 31.62 + 0.03655 * \Sigma T$  | 98.68                 | 1.952 |
|                    | Q     | $De = 28.37 + 0.05246 * \Sigma T - 0.000011 * \Sigma T^2$                      | 99.95                 | 0.390 |
|                    | K     | $De = 28.51 + 0.05095 * \Sigma T - 0.000009 * \Sigma T^2 - 0.000 * \Sigma T^3$ | 99.95                 | 0.394 |
| 29.89<br>(29 – 31) | L     | $De = 33.27 + 0.03854 * \Sigma T$  | 98.66                 | 2.068 |
|                    | Q     | $De = 29.82 + 0.05542 * \Sigma T - 0.000012 * \Sigma T^2$                      | 99.95                 | 0.397 |
|                    | K     | $De = 29.95 + 0.05397 * \Sigma T - 0.000009 * \Sigma T^2 - 0.000 * \Sigma T^3$ | 99.95                 | 0.402 |
| 31.28<br>(29 – 31) | L     | $De = 34.87 + 0.04023 * \Sigma T$  | 98.64                 | 2.158 |
|                    | Q     | $De = 31.28 + 0.05782 * \Sigma T - 0.000013 * \Sigma T^2$                      | 99.95                 | 0.430 |
|                    | K     | $De = 31.43 + 0.05612 * \Sigma T - 0.000009 * \Sigma T^2 - 0.000 * \Sigma T^3$ | 99.94                 | 0.434 |
| 32.20<br>(31 – 33) | L     | $De = 37.78 + 0.04180 * \Sigma T$  | 97.56                 | 2.890 |
|                    | Q     | $De = 32.81 + 0.06751 * \Sigma T - 0.000019 * \Sigma T^2$                      | 99.96                 | 0.382 |
|                    | K     | $De = 32.13 + 0.07514 * \Sigma T - 0.000035 * \Sigma T^2 + 0.000 * \Sigma T^3$ | 99.91                 | 0.552 |
| 33.77<br>(33 – 35) | L     | $De = 39.61 + 0.04384 * \Sigma T$  | 97.58                 | 3.016 |
|                    | Q     | $De = 34.41 + 0.07069 * \Sigma T - 0.000020 * \Sigma T^2$                      | 99.96                 | 0.386 |
|                    | K     | $De = 33.71 + 0.07858 \Sigma T - 0.000036 * \Sigma T^2 + 0.000 * \Sigma T^3$   | 99.92                 | 0.554 |

**Tabela 3.40. Krahasimi i tre modeleve të ekuacioneve për diametrat gjatësore**  
( $p < 0.05$ )

| De (mm)<br>40 DPLP | Model | Ekuacionet e regresionit për grup diametrat gjatësorë                           | R <sup>2</sup><br>(%) | DS    |
|--------------------|-------|---|-----------------------|-------|
| 28.80<br>(27 – 30) | L     | $Dgj = 30.71 + 0.03154 * \Sigma T$  | 98.88                 | 1.550 |
|                    | Q     | $Dgj = 28.18 + 0.04394 * \Sigma T - 0.000009 * \Sigma T^2$                      | 99.93                 | 0.383 |
|                    | K     | $Dgj = 28.54 + 0.03991 * \Sigma T - 0.000001 * \Sigma T^2 - 0.000 * \Sigma T^3$ | 99.91                 | 0.432 |
| 30.23<br>(30 – 32) | L     | $Dgj = 32.30 + 0.03305 * \Sigma T$  | 98.85                 | 1.641 |
|                    | Q     | $Dgj = 29.60 + 0.04626 * \Sigma T - 0.00009 * \Sigma T^2$                       | 99.94                 | 0.382 |
|                    | K     | $Dgj = 29.93 + 0.04260 * \Sigma T - 0.000003 * \Sigma T^2 - 0.000 * \Sigma T^3$ | 99.92                 | 0.421 |
| 31.92<br>(31 – 34) | L     | $Dgj = 34.03 + 0.03496 * \Sigma T$  | 98.83                 | 1.755 |
|                    | Q     | $Dgj = 31.19 + 0.04890 * \Sigma T - 0.000010 * \Sigma T^2$                      | 99.92                 | 0.465 |
|                    | K     | $Dgj = 31.65 + 0.04372 * \Sigma T - 0.000000 \Sigma T^2 - 0.000 * \Sigma T^3$   | 99.89                 | 0.533 |
| 32.82<br>(31 – 34) | L     | $Dgj = 35.89 + 0.03683 * \Sigma T$  | 98.18                 | 2.193 |
|                    | Q     | $Dgj = 32.12 + 0.05630 * \Sigma T - 0.000015 * \Sigma T^2$                      | 99.94                 | 0.389 |
|                    | K     | $Dgj = 32.50 + 0.05197 * \Sigma T - 0.000006 * \Sigma T^2 - 0.000 * \Sigma T^3$ | 99.93                 | 0.441 |
| 34.45<br>(33 – 36) | L     | $Dgj = 37.61 + 0.03872 \Sigma T$  | 98.14                 | 2.314 |
|                    | Q     | $Dgj = 33.63 + 0.05928 * \Sigma T - 0.000016 * \Sigma T^2$                      | 99.95                 | 0.394 |
|                    | K     | $Dgj = 34.04 + 0.05464 * \Sigma T - 0.000006 * \Sigma T^2 - 0.000 * \Sigma T^3$ | 99.93                 | 0.455 |

Edhe në krahasimin e të dhënave të Tabelës 3.40, për të pese interval diametrat gjatësore të kultivarit Granny Smith, rezulton se modeli kuadratik ka qene me i

përshtatshmi në përshkrimin e marrëdhënies ndërmjet rritjes së këtyre diametrave dhe shumës së temperaturave ditore të rritjes nga 40 – 159 DPLP, sepse edhe për këtë grup diametrash Koeficienti i Përcaktueshmërisë ( $R^2$ ) i këtij modeli ishte me i larti ndërsa Deviacioni Standard me i ulëti.

Në pikëpamjen praktike përshtatshmëria me e madhe e modelit kuadratik do të thotë se rritja e diametrave ekuatorialë dhe gjatësorë ka ndjekur modelin e një vije të lakuar, pa ulje-ngritje të ndjeshme, të cilat nëse ndodhnin do ti jepnin nga ana statistikore përshtatshmëri me të madhe modelit kubik.

Kjo nënkupton që shërbimet agroteknike dhe veçanërisht ujitjet gjate periudhës së rritjes së frutave kanë qene të mjaftueshme për të mos shkaktuar diferenca të ndjeshme në ritmiken e zmadhimit të frutave.

### **3.3.2. PËRPILIMI I TABELËS PARASHIKUESE PËR RITJEN E DIAMETRIT EKUATORIAL DHE GJATËSOR TË KULTIVARIT GRANNY SMITH NË LIDHJE ME SHUMAT FIKSE TË TEMPERATURAVE DITORE RITJES NË TË DY VITET**

Ekuacionet kuadratike të regresionit për secilin diametër mesatar ekuatorial dhe gjatësor të Tabelës 3.39 dhe Tabelës 3.40 u përdorën për të realizuar përpilimin e tabelave parashikuese të rritjes të kultivarit Granny Smith. Si variabla të pavarura në këto ekuacione u morën vlerat fikse të shumave të temperaturave ditore të rritjes nga  $\Sigma T=100^{\circ}\text{C}$ ,  $\Sigma T=150^{\circ}\text{C}$ ,  $\Sigma T=200^{\circ}\text{C}$  ....deri në  $\Sigma T=1400^{\circ}\text{C}$  (Tabela 3.41).

Në një vrojtim pese vjeçar (2009 – 2013) në lidhje me shumën e temperaturave ditore të rritjes ( $\Sigma T$ ) të grumbulluar nga 40 DPLP deri në 159 DPLP rezultoi se mesatarja e tyre për këto vite ishte  $1288^{\circ}\text{C}$ .

Në vitin me të ngrohte që përkon me atë 2012, gjate periudhës të sipërpërmendur 40 – 159 DPLP u grumbulluan  $1368^{\circ}\text{C}$ , ndërsa në vitin 2013 për të njëjtën periudhe u grumbulluan  $1280^{\circ}\text{C}$ , vlere kjo shume afër mesatares së këtyre pese viteve.

Sic u përmend edhe për dy kultivarët e tjerë në këtë studim, në vite me temperature normale gjate sezonit të rritjes së frutave nga 40 DPLP deri në vjelje, dhe në kushtet e zbatimit të shërbimeve agroteknike të njëjta çdo vit, përfshirë këtu dhe ngarkesën e njëjtë me fruta për çdo  $\text{cm}^2$  të sipërfaqes të prerjes tërthore të trungut, ecuria e rritjes e frutave do të jete shume e ngjashme nga njeri vit në tjetrin. Në kushte të tilla, madhësia e diametrit të frutave të mollës në 40 DPLP do të ishte vendimtar në madhësinë përfundimtare të tyre (Berg 1990; Warrington et al., 1999)


**Tabela 3.41. Rritja e diametrave të Granny Smith dhe temperaturat e rritjes**

| ΣT<br>(°C) | Grupet e frutave në lidhje me ΣT |       |         |       |         |       |         |       |         |       |
|------------|----------------------------------|-------|---------|-------|---------|-------|---------|-------|---------|-------|
|            | Grupi 1                          |       | Grupi 2 |       | Grupi 3 |       | Grupi 4 |       | Grupi 5 |       |
|            | De                               | Dgj   | De      | Dgj   | De      | Dgj   | De      | Dgj   | De      | Dgj   |
| 0.0        | 28.37                            | 28.80 | 29.89   | 30.23 | 31.28   | 31.92 | 32.20   | 32.82 | 33.77   | 34.45 |
| 100.0      | 33.51                            | 32.48 | 35.24   | 34.14 | 36.93   | 35.98 | 39.37   | 37.60 | 41.28   | 39.40 |
| 150.0      | 35.99                            | 34.57 | 37.86   | 36.34 | 39.66   | 38.30 | 42.51   | 40.23 | 44.56   | 42.16 |
| 200.0      | 38.42                            | 36.61 | 40.42   | 38.49 | 42.32   | 40.57 | 45.55   | 42.78 | 47.75   | 44.85 |
| 250.0      | 40.80                            | 38.60 | 42.93   | 40.60 | 44.92   | 42.79 | 48.50   | 45.26 | 50.83   | 47.45 |
| 300.0      | 43.12                            | 40.55 | 45.37   | 42.67 | 47.46   | 44.96 | 51.35   | 47.66 | 53.82   | 49.97 |
| 350.0      | 45.38                            | 42.46 | 47.75   | 44.69 | 49.92   | 47.08 | 54.11   | 49.99 | 56.70   | 52.42 |
| 400.0      | 47.59                            | 44.32 | 50.07   | 46.66 | 52.33   | 49.15 | 56.77   | 52.24 | 59.49   | 54.78 |
| 450.0      | 49.75                            | 46.13 | 52.33   | 48.59 | 54.67   | 51.17 | 59.34   | 54.42 | 62.17   | 57.07 |
| 500.0      | 51.85                            | 47.90 | 54.53   | 50.48 | 56.94   | 53.14 | 61.82   | 56.52 | 64.76   | 59.27 |
| 550.0      | 53.90                            | 49.62 | 56.67   | 52.32 | 59.15   | 55.06 | 64.19   | 58.55 | 67.24   | 61.39 |
| 600.0      | 55.89                            | 51.30 | 58.75   | 54.12 | 61.29   | 56.93 | 66.48   | 60.50 | 69.62   | 63.44 |
| 650.0      | 57.82                            | 52.94 | 60.77   | 55.87 | 63.37   | 58.75 | 68.66   | 62.38 | 71.91   | 65.40 |
| 700.0      | 59.70                            | 54.53 | 62.73   | 57.57 | 65.38   | 60.52 | 70.76   | 64.18 | 74.09   | 67.29 |
| 750.0      | 61.53                            | 56.07 | 64.64   | 59.23 | 67.33   | 62.24 | 72.76   | 65.91 | 76.18   | 69.09 |
| 800.0      | 63.30                            | 57.57 | 66.48   | 60.85 | 69.22   | 63.91 | 74.66   | 67.56 | 78.16   | 70.81 |
| 850.0      | 65.01                            | 59.03 | 68.26   | 62.42 | 71.03   | 65.53 | 76.47   | 69.14 | 80.05   | 72.46 |
| 900.0      | 66.67                            | 60.44 | 69.98   | 63.94 | 72.79   | 67.10 | 78.18   | 70.64 | 81.83   | 74.02 |
| 950.0      | 68.28                            | 61.80 | 71.64   | 65.42 | 74.48   | 68.62 | 79.80   | 72.07 | 83.52   | 75.51 |
| 1000.0     | 69.83                            | 63.12 | 73.24   | 66.86 | 76.10   | 70.09 | 81.32   | 73.42 | 85.10   | 76.91 |
| 1050.0     | 71.33                            | 64.39 | 74.78   | 68.25 | 77.66   | 71.51 | 82.75   | 74.70 | 86.58   | 78.23 |
| 1100.0     | 72.77                            | 65.62 | 76.26   | 69.60 | 79.15   | 72.88 | 84.08   | 75.90 | 87.97   | 79.48 |
| 1150.0     | 74.15                            | 66.81 | 77.68   | 70.90 | 80.58   | 74.20 | 85.32   | 77.03 | 89.25   | 80.64 |
| 1200.0     | 75.48                            | 67.95 | 79.04   | 72.15 | 81.94   | 75.47 | 86.46   | 78.08 | 90.44   | 81.73 |
| 1250.0     | 76.76                            | 69.04 | 80.35   | 73.36 | 83.24   | 76.69 | 87.51   | 79.06 | 91.52   | 82.73 |
| 1300.0     | 77.98                            | 70.09 | 81.59   | 74.53 | 84.48   | 77.86 | 88.46   | 79.96 | 92.51   | 83.65 |
| 1350.0     | 79.14                            | 71.10 | 82.77   | 75.65 | 85.64   | 78.98 | 89.32   | 80.79 | 93.39   | 84.50 |
| 1400.0     | 80.25                            | 72.06 | 83.89   | 76.72 | 86.75   | 80.05 | 90.08   | 81.54 | 94.18   | 85.26 |

Nga ana tjetër, shembujt e literaturës kanë treguar se kur temperaturat ditore të rritjes kanë qene mjaft me të larta se mesatarja shumëvjeçarë, rritja e frutave ka rënë përkundjet ritmit normal, sepse mollët kalojnë në gjendje stresi nga temperatura (Berg dhe Lotze, 2006).

Në Tabelën 3.41 vlerat e diametrave tregojnë se deri në vjelje, grupet e frutave të mollës kultivarit Granny Smith me diametra me të vegjël në 40 DPLP rriten me pak se ata me diametra me të mëdhenj në po atë date. Kështu, diferenca ndërmjet grupit të parë diametrit ekuatorial me atë të grupit të pestë në 40 DPLP ishte 5.40 mm, ndërsa në vjelje ajo u zgjerua në 13.93 mm (Grafiku 3.1).

Në të njëjtën mënyrë, diferenca ndërmjet grup diametrave gjatësorë perkates, për të periudhën si me sipër (0.0°C – 1400°C) u zgjerua nga 5.65 mm në 13.20 mm. Ashtu sic u përmend për kultivarët Golden Delicious dhe Red Chief pjesë të këtij studimi, edhe në rastin e Granny Smith frutat e mëdhenj kanë ritëm me të lartë rritje se frutat me të vegjël. Një përfundim i tillë është në përputhje me konkluzionet e nxjerra nga Lakso dhe Goffinet (2013) të cilët provuan se brenda një peme molle, frutat që janë me diametër të vogël në 40 DPLP nuk mund të arrijnë kurrë gjatë rritjes frutat që kanë me diametër me të madh në atë date, prandaj periudhën 40 ditore pas lulëzimit të plote, ata e përcaktuan si shumë të rëndësishme në të gjithë sezonin në lidhje me madhësinë në vjelje të frutave të mollës (Lakso dhe Goffinet, 2013).



**Grafiku 3.5. Rritja e diferencës mes grup-diametrave ekuatoriale të kultivari Granny Smith**



### 3.3.3. PËRLLLOGARITJA E EKUACIONEVE TË REGRESIONIT QË SHPREHIN MARRËDHËNIEN NDËRMJET PESHËS SË FRUTAVE TË GRANNY SMITH NË FUNKSION TË DIAMETRAVE EKUATORIALE DHE GJATËSORE TË TYRE.

Në 159 ditë pas lulëzimit të plote, të gjithë frutat e etiketuar të kultivarit Granny Smith, pasi u maten diametrat ekuatoriale dhe gjatësorë të tyre u volën dhe çdo frut u peshua veçmas në peshoren elektronike. Të dhënat përkatëse të peshës për secilin frut në të dy vitet 2012 dhe 2013 u hodhën në regjistrin elektronik në kolonën ngjitur me atë të diametrave përfundimtarë. Nga numri fillestar prej 200 frutash të etiketuar në 40 DPLP, në vitin 2012 në vjelje kishin mbetur 177 fruta, ndërsa në vitin 2013 ishin 182 fruta. Të tjerët kishin rënë për shkaqe të ndryshme. Për të përpiluar tabelën parashikuese të peshës së frutave në lidhje me diametrat e tyre përkatës në momentin e vjeljes (159 DPLP), u përdor ekuacioni i shumëfishtë i regresionit:

$$\text{Pesha} = b_0 + b_1De + b_2Dgj$$

Marrëdhënia ndërmjet diametrave ekuatoriale e gjatësorë të frutave dhe peshës së tyre e shprehur nga ekuacioni i mësipërm për secilin nga e pese grupet e diametrave ishte i një saktësie të lartë, me një gabim në vlerë absolute prej më pak se 0.3 g/frut (Tabela 3.42). Në të pese ekuacionet, vlera e Koeficientit të Përcaktueshmërisë ( $R^2$ ) ishte shumë e lartë, në diapazonin 0.977 – 0.999, ndërsa deviacioni standard (DS) 0.370 – 0.558. Me këto nivele shumë të lartë saktësie, ekuacionet e secilit grup mund të përdoren për të parashikuar peshën përfundimtare të çdo fruti molle brenda grupit përkatës të diametrave. Krahasimi i peshës mesatare të frutave në momentin e vjeljes tregoi një diferencë të madhe mes grupeve, pasi frutat e grupit të pestë (me diametra më të mëdhenj) kishin një peshe 1.48 herë më të madhe (315.0 g / 213.2 g) se ata të grupit të parë (me diametrat më të vegjël). Sic u përmend edhe tek dy kultivarët e tjerë në këtë studim, edhe Granny Smith ky përfundim është në të njëjtën drejtim me atë që kanë nxjerre në pah Lakso dhe Goffinet (2013) në lidhje me rolin që ka madhësia e diametrit të frutit në 40 DPLP në peshën përfundimtare të tij.

**Tabela 3.42. Pesha e frutit e Granny Smith për secilin grup diametrash në 159 DPLP**

( $p < 0.05$ )

| Grupet e frutave | De & Dgj (mm) 159 DPLP |       | Ekuacionet e regresionit të peshës për grupet e diametrave 159 DPLP | $R^2$ | DS    | Pesha (g) e frutit 159 DPLP |
|------------------|------------------------|-------|---|-------|-------|-----------------------------|
|                  | De                     | Dgj   |   |       |       |                             |
| 1                | 78.40                  | 71.13 | $M = -373 + 4.85*De + 2.90*Dl$                                      | 0.998 | 0.409 | 213.2 ±0.1                  |
| 2                | 82.59                  | 74.76 | $M = -378 + 5.08*De + 2.71*Dl$                                      | 0.999 | 0.396 | 243.9 ±0.1                  |

|   |       |       |                                |       |       |            |
|---|-------|-------|--------------------------------|-------|-------|------------|
| 3 | 86.34 | 78.73 | $M = -390 + 4.93*De + 3.02*DI$ | 0.977 | 0.558 | 273.6 ±0.2 |
| 4 | 87.58 | 79.58 | $M = -389 + 4.99*De + 2.95*DI$ | 0.999 | 0.370 | 282.1 ±0.1 |
| 5 | 91.85 | 83.53 | $M = -389 + 5.02*De + 2.92*DI$ | 0.998 | 0.440 | 315.0 ±0.1 |

Duke përdorur vlerat e diametrave ekuatorialë dhe gjatësorë të regjistruar në 138, 145 dhe 152 DPLP si variabla të pavarura në ekuacionin e shumëfishtë të regresionit si me sipër, u përgatit një tabelë parashikuese për peshën e frutave në të tre këto data për kultivarin Granny Smith (Tabela 3.43).

**Tabela 3.43. Parashikimi i peshës së frutave të Granny Smith në 138, 145 dhe 152 DPLP**

| Grupet e frutave | De & Dgj (mm) dhe pesha (g) 138 DPLP |       |        | De & Dgj (mm) dhe pesha (g) 145 DPLP |       |        | De & Dgj (mm) dhe pesha (g) 152 DPLP |       |        |
|------------------|--------------------------------------|-------|--------|--------------------------------------|-------|--------|--------------------------------------|-------|--------|
|                  | De                                   | Dgj   | Pesha* | De                                   | Dgj   | Pesha* | De                                   | Dgj   | Pesha* |
| 1                | 76.10                                | 69.15 | 196.1  | 77.05                                | 69.91 | 202.9  | 77.88                                | 70.59 | 209.0  |
| 2                | 80.17                                | 72.48 | 225.3  | 81.17                                | 73.38 | 232.8  | 82.04                                | 74.09 | 239.2  |
| 3                | 83.83                                | 76.64 | 253.9  | 84.87                                | 77.48 | 261.8  | 85.77                                | 78.14 | 268.5  |
| 4                | 85.05                                | 77.68 | 263.7  | 86.10                                | 78.51 | 271.5  | 87.28                                | 79.44 | 280.2  |
| 5                | 89.19                                | 81.53 | 295.3  | 90.3                                 | 82.41 | 303.6  | 91.53                                | 83.38 | 312.8  |

\* $p < 0.05$

Duke bërë krahasimin e peshës së frutave të secilit grup në 138, 145 dhe 152 DPLP (Tabela 3.43) me peshën përfundimtare në vjelje (Tabela 3.42) rezulton se për periudhën 21 ditore 138 – 159 DPLP frutat e grupit të parë kishin shtuar mesatarisht 17.1 g, të grupit të dytë 18.6 g, të grupit të tretë 19.7 g; të grupit të katërt 18.4 g, dhe të grupit të pestë 19.7 g, ndërsa mesatarja e shtesës për të pesë grupet 18.7 g.

Rritja e peshës në përqindje për periudhën e sipërpërmendur 21 ditore tregon se rreth 41% e saj ka ndodhur në shtatë ditoret e parë (138 – 145 DPLP), 40% në të dytin (145 -152 DPLP) dhe 19% në të tretin (152 -159 DPLP).

Reduktimi i shtimit në peshe në javën e fundit tregon se frutat kanë hyre në periudhën klimakterike, në të cilën rritja e tyre bie në minimum (Golding dhe Jobling, 2012).

### **3.3.4. PËRCAKTIMI I PERIUdhËS SË VJELJES BAZUAR NË TREGUESIT E PJEKJES SË FRUTAVE**

Për kultivarin Granny Smith u maten tre tregues të pjekjes të frutave në secilin vit të studimit: **fortësia**, **totali i lendeve të tretshme** dhe **treguesi i amidonit**. Matjet u kryen shtatë here me mostra prej 20 frutash çdo radhe, në intervale kohore pese ditore: në 130, 135, 140, 145, 150, 155 (gjashtë here) dhe e fundit

pas katër ditësh, në vjelje 159 DPLP. Në vitin 2012 ato korresponduan me datat 12, 17, 22, 27 Shtator dhe 2, 7 dhe 11 Tetor, ndërsa në vitin 2013 me datat 5, 10, 15, 20, 25, 30 Shtator dhe 4 Tetor.



**Foto 3.5. Matja e fortësisë së kultivarit Granny Smith 159 DPLP (viti 2013)**

### **Fortësia e frutave**

Të dhënat nga matjet e fortësisë së frutave në vitin 2012 dhe 2013 jepen në Tabelën 3.44 dhe Tabelën 3.45. Rezulton se në të dy vitet fortësia ka ardhur në rënie nga njëra matje në tjetrën. Ky është një proces i natyrshëm që shoqëron pjekjen e frutave dhe ndodh për shkak të veprimit të hormonit etilen (Golding dhe Jobling, 2012).

**Tabela 3.44. Fortësia e frutave e Granny Smith (viti 2012)**

| Fruti | 12 Shtator<br>130 DPLP | 17 Shtator<br>135 DPLP | 22 Shtator<br>140 DPLP | 27 Shtator<br>145 DPLP | 02 Tetor<br>150 DPLP | 07 Tetor<br>152 DPLP | 11 Tetor<br>159 DPLP |
|-------|------------------------|------------------------|------------------------|------------------------|----------------------|----------------------|----------------------|
| 1     | 9.3                    | 9.0                    | 8.9                    | 8.6                    | 8.5                  | 8.4                  | 8.2                  |
| 2     | 9.6                    | 9.1                    | 9.0                    | 8.8                    | 8.5                  | 8.4                  | 8.3                  |
| 3     | 9.4                    | 9.2                    | 8.8                    | 8.6                    | 8.6                  | 8.3                  | 8.3                  |
| 4     | 9.5                    | 9.2                    | 8.8                    | 8.7                    | 8.4                  | 8.4                  | 8.4                  |
| 5     | 9.4                    | 9.0                    | 8.9                    | 8.7                    | 8.6                  | 8.4                  | 8.3                  |
| 6     | 9.7                    | 9.1                    | 8.9                    | 8.8                    | 8.5                  | 8.5                  | 8.3                  |
| 7     | 9.3                    | 9.2                    | 9.0                    | 8.7                    | 8.5                  | 8.4                  | 8.3                  |
| 8     | 9.5                    | 9.0                    | 8.9                    | 8.6                    | 8.6                  | 8.4                  | 8.4                  |
| 9     | 9.4                    | 9.1                    | 8.9                    | 8.7                    | 8.6                  | 8.4                  | 8.3                  |
| 10    | 9.3                    | 9.1                    | 9.0                    | 8.6                    | 8.5                  | 8.5                  | 8.3                  |
| 11    | 9.4                    | 9.1                    | 8.8                    | 8.7                    | 8.4                  | 8.4                  | 8.3                  |

|                 |            |            |            |            |            |            |            |
|-----------------|------------|------------|------------|------------|------------|------------|------------|
| 12              | 9.2        | 9.2        | 8.9        | 8.6        | 8.5        | 8.4        | 8.4        |
| 13              | 9.3        | 9.0        | 8.8        | 8.8        | 8.4        | 8.3        | 8.3        |
| 14              | 9.4        | 8.9        | 9.0        | 8.7        | 8.6        | 8.4        | 8.2        |
| 15              | 9.3        | 9.1        | 8.9        | 8.7        | 8.5        | 8.4        | 8.2        |
| 16              | 9.5        | 9.2        | 8.8        | 8.6        | 8.5        | 8.4        | 8.3        |
| 17              | 9.4        | 9.1        | 8.9        | 8.7        | 8.4        | 8.5        | 8.3        |
| 18              | 9.3        | 9.2        | 9.0        | 8.8        | 8.5        | 8.4        | 8.2        |
| 19              | 9.4        | 9.0        | 8.8        | 8.7        | 8.4        | 8.3        | 8.3        |
| 20              | 9.4        | 9.1        | 9.0        | 8.8        | 8.5        | 8.4        | 8.3        |
| <b>Mesatare</b> | <b>9.4</b> | <b>9.1</b> | <b>8.9</b> | <b>8.7</b> | <b>8.5</b> | <b>8.4</b> | <b>8.3</b> |

Sic tregohet dhe në Tabelën 3.44 fortësia mesatare e frutave në periudhën 29 ditore nga 130 – 159 DPLP eshte ulur gjithsej me 1.1 kg/cm<sup>2</sup>, ose 0.038 kg/cm<sup>2</sup> në dite, ndërsa për të njëjtën periudhe të vitit 2013 (Tabela 3.45) ajo eshte ulur me 0.9 kg/cm<sup>2</sup>, ose 0.031 kg.cm<sup>2</sup> në dite. Megjithatë në momentin e vjeljes (159 DPLP) fortësia mesatare e frutave në të dy vitet ka qene e njëjtë: 8.3 kg/cm<sup>2</sup>. Krahasuar me kultivarët Golden Delicious dhe Red Chief, fortësia frutave të Granny Smith ka qene me larte për çdo date përkatëse të matjes, dhe kjo i dedikohet tullit të tij të ngjeshur me hapësira me të vogla ndërqelizore, pra teksturës së tij kompakte (Hampson dhe Kemp, 2003).

**Tabela 3.45. Fortësia e frutave e Granny Smith (viti 2013)**

| Fruti | 05 Shtator<br>130 DPLP | 10 Shtator<br>135 DPLP | 15 Shtator<br>140 DPLP | 20 Shtator<br>145 DPLP | 25 Shtator<br>150 DPLP | 30 Shtator<br>152 DPLP | 04 Tetor<br>159 DPLP |
|-------|------------------------|------------------------|------------------------|------------------------|------------------------|------------------------|----------------------|
| 1     | 9.3                    | 9.0                    | 8.7                    | 8.6                    | 8.6                    | 8.5                    | 8.2                  |
| 2     | 9.2                    | 9.0                    | 8.8                    | 8.7                    | 8.6                    | 8.5                    | 8.3                  |
| 3     | 9.3                    | 8.9                    | 8.9                    | 8.7                    | 8.5                    | 8.5                    | 8.4                  |
| 4     | 9.1                    | 9.0                    | 8.8                    | 8.7                    | 8.6                    | 8.5                    | 8.3                  |
| 5     | 9.2                    | 9.0                    | 8.8                    | 8.6                    | 8.6                    | 8.4                    | 8.3                  |
| 6     | 9.2                    | 9.0                    | 8.9                    | 8.8                    | 8.5                    | 8.5                    | 8.2                  |
| 7     | 9.3                    | 9.0                    | 8.7                    | 8.7                    | 8.6                    | 8.5                    | 8.3                  |
| 8     | 9.2                    | 9.0                    | 8.8                    | 8.7                    | 8.6                    | 8.5                    | 8.3                  |
| 9     | 9.2                    | 9.0                    | 8.8                    | 8.8                    | 8.6                    | 8.5                    | 8.4                  |
| 10    | 9.1                    | 9.0                    | 8.8                    | 8.7                    | 8.6                    | 8.6                    | 8.3                  |
| 11    | 9.2                    | 8.9                    | 8.9                    | 8.7                    | 8.7                    | 8.5                    | 8.2                  |
| 12    | 9.2                    | 9.0                    | 8.9                    | 8.7                    | 8.6                    | 8.5                    | 8.3                  |
| 13    | 9.2                    | 9.1                    | 8.7                    | 8.7                    | 8.6                    | 8.4                    | 8.4                  |
| 14    | 9.3                    | 9.0                    | 8.8                    | 8.6                    | 8.6                    | 8.5                    | 8.2                  |
| 15    | 9.1                    | 9.1                    | 8.8                    | 8.7                    | 8.7                    | 8.6                    | 8.3                  |
| 16    | 9.2                    | 9.0                    | 8.8                    | 8.7                    | 8.6                    | 8.5                    | 8.4                  |
| 17    | 9.2                    | 9.0                    | 8.7                    | 8.7                    | 8.5                    | 8.5                    | 8.3                  |
| 18    | 9.2                    | 9.1                    | 8.9                    | 8.8                    | 8.6                    | 8.6                    | 8.2                  |
| 19    | 9.2                    | 8.9                    | 8.7                    | 8.7                    | 8.6                    | 8.5                    | 8.4                  |

|                 |     |     |     |     |     |     |     |
|-----------------|-----|-----|-----|-----|-----|-----|-----|
| 20              | 9.1 | 9.0 | 8.8 | 8.7 | 8.6 | 8.4 | 8.3 |
| <b>Mesatare</b> | 9.2 | 9.0 | 8.8 | 8.7 | 8.6 | 8.5 | 8.3 |

### **Totali i lendeve të tretshme**

Në matjen e pare në vitin 2012 të realizuar 130 DPLP, totali i lendeve të tretshme të kultivarit Granny Smith ka qene 9.5<sup>0</sup> Briks, ndërsa në të njëjtën periudhe të vitit 2013 ai ishte 9.4<sup>0</sup> Briks Në periudhën 29 ditore nga 130 – 159 DPLP, ky tregues për vitin 2012 është rritur me 2.4<sup>0</sup> Briks kundrejt 2.1<sup>0</sup> Briks në vitin 2013 duke arritur përkatësisht vlerat 11.9<sup>0</sup> Briks në 2012 dhe 11.5<sup>0</sup> Briks në 2013. Të dhënat për totalin e lendeve të tretshme për vitin 2012 dhe 2013 jepen në Tabelën 3.46 dhe Tabelën 3.47.

Ashtu si për kultivarët Golden Delicious e Red Chief në këtë studim, edhe për Granny Smith kushtet klimatike gjate sezonit të rritjes e pjekjes së frutave në vitin 2012, me temperature ditore të rritjes 97.5<sup>0</sup>C me të larte në muajt Korrik, Gusht, Shtator se në të njëjtën periudhe të vitit 2013 ndikuan në nivelin me të larte të totalit të lendeve të tretshme në vitin 2012.

**Tabela 3.46. Totali i lendeve të tretshme i Granny Smith (viti 2012)**

| Fruti           | 12 Shtator<br>130 DPLP | 17 Shtator<br>135 DPL | 22 Shtator<br>140 DPLP | 27 Shtator<br>145 DPLP | 02 Tetor<br>150 DPLP | 07 Tetor<br>152 DPLP | 11 Tetor<br>159 DPLP |
|-----------------|------------------------|-----------------------|------------------------|------------------------|----------------------|----------------------|----------------------|
| 1               | 9.4                    | 10.0                  | 10.7                   | 11.0                   | 11.6                 | 11.7                 | 12.0                 |
| 2               | 9.3                    | 10.1                  | 10.5                   | 11.2                   | 11.4                 | 11.8                 | 11.9                 |
| 3               | 9.5                    | 9.9                   | 10.3                   | 11.3                   | 11.6                 | 11.6                 | 11.9                 |
| 4               | 9.6                    | 9.8                   | 10.4                   | 11.0                   | 11.4                 | 11.7                 | 11.8                 |
| 5               | 9.5                    | 10.1                  | 10.6                   | 10.9                   | 11.5                 | 11.7                 | 12.0                 |
| 6               | 9.6                    | 9.9                   | 10.5                   | 11.1                   | 11.5                 | 11.7                 | 11.9                 |
